

# MBUROJA



Numri 147  
Janar 2021

ISSN 1857-7792



REVISTË E MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Republika së Maqedonisë së Veriut

## Pjesë e patrullimit ajror të NATO-s



Inervistë me  
gjeneralin Fernando  
De La Kruz Karavaka





# Qielli i Republikës së Maqedon e sistemit të patrullimit a

**Q**ielli i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fillimin zyrtarë të misionit të NATO-s “Air Policing” në vendin tonë, edhe zyrtarisht u bë pjesë e sistemit kolektiv të Aleancës për patrullimin ajror. Realizimi i misionit “Air Policing” në vendin tonë dëshmon qartë funksionimin e mbrojtjes kolektive të të gjitha vendeve anëtare të Aleancës. Më 9 dhjetor në kazermën “Petrovec” u mbajt ceremoni për shënimin e fillimit të këtij misioni, për realizimin e së cilës më 15 nëntor të këtij viti u nënshkrua edhe aranzhim teknik. Në këtë ngjarje u përfshi edhe avioni i NATO-s i llojit “Awaks E-3A”, i obliguar për komandë

dhe kontroll, gjahtarë i forcave ajrore greke i llojit “F-16” si dhe avioni qeveritar “Learjet”. Në këtë manifestim morrën pjesë ministrja e mbrojtjes Radmilla Shekerinska, komandanti i qendrës së kombinuar operative ajrore në Torehon të Spanjës, gjeneral-nënkolonel Fernando de la Kruz Karavaka, ministra të Qeverisë, deputetë të Kuvendit republikan, përfaqësues të korit ushtarako-diplomatik në vendin tonë, etj. Misioni i patrullimit ajror në qiellin tonë udhëhiqet nga ana e Komanda Aleate Ajrore e NATO-s, kontrollin taktik të misionit e udhëheq Qendra për Operacione të Kombinuara Ajrore në Torehon të Spanjës, ndërsa kapacitetet

ajrore për realizimin e këtij misioni vijnë nga forcat ajrore greke. NATO misioni për patrullimin në qiellin e Maqedonisë së Veriut është në fakt mbështetje e “Air Policing” misionit në të cilin Maqedonia e Veriut e dakordoi në mënyrë bilaterale me Republikën e Greqisë në shtator të vitit 2019, e që nga sot do të udhëhiqet nën komandën e NATO-s. “Këtu në aeroportin e Petrovecit, kishim mundësinë të shohim se si duket një mision i NATO-s për patrullim në qiellin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku edhe hapësira jonë ajror, në tërësi iu bashkangjiti sistemit të NATO-s për patrullim ajror, ndërsa nga dita e sotme mund të themi se siguria e qiellit tonë



# përmbajtja

MBUROJA ■ viti XII ■ numri 147 ■ janar 2021

Intervistë me  
**gjeneralin Fernando  
de la Kruz Karavaka** 5

NATO-aktivitete  
**Qendrat e përsosshmërisë  
së NATO-s** 8

NATO-aktivitete  
**Intelegjenca artificiale e NATO-s:  
adoptimi dinamik, përdorimi i  
përgjegjshëm – pjesa e dytë** 10

Misionet paqësore  
**Nën flamurin e OKB-së  
Vendosja e misionit paqeruajtës** 13

Edukim ushtarak  
**Inovacioni i fshehtë** 20

Barazia gjinore  
**Konferenca ministrore për  
bashkëpunim rajonal në fushën  
e barazisë gjinore të vendeve të  
Ballkanit Perëndimor** 24

Armatim  
**Automjeti i blinduar „Terrex” 8x8** 32

Armatim  
**„Zulfiqar” – Tanku bazik luftarak** 36

Armatim  
**„Bristol Beaufighter”** 39

Muze ushtarak  
**Muzeu ndërkomëtar  
i spionazhit** 45

Pilotë legjendarë maqedonas  
**Bllazhe Troshanovski  
Entuziast dhe aviator i  
pathyeshëm** 48

Piktorët dhe lufta  
**Kunijoshi ukio-e i fundit** 54

Film  
**„Suita franceze”** 56

**Fshati Tërnovë – fshat me  
natyrë të jashtëzakonshme** 58  
3



## isë së Veriut – pjesë jrorë të NATO-s

është pjesë e sigurisë së NATO-s”, tha ministrja Shekerinska. Ministrja theksoi se Maqedonia e Veriut ishte partnere e sigurt e Aleancës, ndërsa tashmë është aleate e sigurt e NATO-, aleate të cilës mund t’i besohet. “Ina dolëm që për periudhë shumë të shkurtër të përfundojmë me integrimin ushtarak në NATO dhe për këtë vazhdojmë më tej që të rrisim buxhetin tonë në pjesën e mbrojtjes, financimin e shkathtësive tona të mbrojtjes, por edhe të rrisim nivelin e kontributit tonë ndaj sigurisë rajonale. “Së bashku jemi më të fortë”, kjo ishte motoja jonë, motivi ynë për të qenë pjesë e NATO-s. Sot pamë se kjo garanci dhe ky anëtarim do të thotë siguri dhe garanci më e madhe

për të gjithë qytetarët tanë, si në tokë, ashtu edhe në ajër”, tha ajo. Ministrja Shekerinska u falenderua aleatëve tanë grek të cilët treguan gatishmëri që me kapacitetet e tyre t’a mbrojnë qiellin tonë, gjë që më së miri e dëshmoi se si duhet të bashkëpunojnë dy vende fqinje, mike dhe aleate. Komandanti i Qendrës së Kombinuar Operative Ajrore në Torehon të Spanjës, gjeneral-nënkolonel, Fernando de la Kruz Karavaka, i cili mbërriti me avionin Awaks”, theksoi se vnedi duhet të jetë krenarë që bashkëpunon së bashku me vendet tjera anëtare të NATO-s dhe që e avancoi stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

Kristina Ilievska

# Brifing

**K**y vit është një vit jubilar për Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vitin 2022, do ta shënojmë jubileun 30 vjet nga formimi i armatës sonë dhe gjatë tërë vitin do të rikujtojmë në ngjarjet e rëndësishme që e shënuan formimin dhe zhvillimin e Armatës. Kaluan 30 vjet nga viti i largët 1992, kur edhe zyrtarisht u konstitua Armata e shtetit të pavarur të ri të Maqedonisë. Duke kaluar përmes transformimeve të shumta, të cilët nënkuptonin edhe realizimin e shumë detyrave, ballafaqimin me shumë sfida dhe imperativate – sot, me krenari mund të themi se çdo përpjekje dhe se secili obligim i përmbushur, ia ka vlejtur dhe se pas 30 viteve me të vërtetë kemi armatë e cila është tërësisht e ndërtuar dhe e integruar në NATO, armatë në të cilën punojnë pjesëtarë profesional dhe të përkushtuar. Të gjithë ne të cilët tërë angazhimin tonë profesional e kalojmë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ishim dhe gjithnjë jemi dëshmitarë të drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrës në ndërtimin dhe në zhvillimin e armatës sonë. Dhe për këtë shkak, brifingu për gjendjen e gatishmërisë së Armatës nga ana e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, para presidentit të vendit dhe komandantit suprem të Armatës, ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe na bëri të ndihemi krenarë që jemi pjesë e Armatës dhe e Ministrisë së Mbrojtjes. Në brifingun para presidentit Pendarovski, në të cilën ishin prezent ministria Radmilla Shekerinska, gjeneralë të Armatës, si dhe përfaqësues të kabinetit të presidentit dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, nga ana e shefit të SHP të Armatës, gjenera-nënkolonel, Vasko Gjurçinovskit dhe drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneral-majorit Zoran Mileskit, u prezantua gjendja dhe realizimi i aktiviteteve

të planifikuara sipas fushave të funksionalitetit të cilat janë pjesë e gjendjes së gatishmërisë. Para kreut ushtarak, u prezantuan detyrat e realizuara dhe të arritura të Armatës gjatë vitit 2021, si dhe detyrat kryesore për vitin vijues 2022 në disa fusha. Gjenerali Gjurçinovski theksoi gatishmërinë e komandave dhe njësisve të Armatës për realizimin e të gjitha aktiviteteve nga dinamika e planifikuar në procesin e arritjes së qëllimeve të shkathtësisë së NATO-s. U theksua edhe përkushtimi dhe realizimi profesional i detyrave nga ana e pjesëtarëve të Armatës, ku u realizuan të gjitha aktivitetet dhe detyrat e planifikuara, si dhe përgatitja e ndihmës ndaj institucioneve shtetërore dhe ndaj qytetarëve.

Ministrja Radmilla Shekerinska në fjalën e saj në këtë brifing potencoi përvjetorin e anëtarimit në NATO, duke theksuar: “Punuam zellshëm edhe në aspektin e integritetit ushtarak dhe atë e përfuduan në kohë rekorde, për vetëm 19 muaj, ku u bëmë të njohur si vend anëtar në NATO i cili më shpejtë se kushdo tjetër e ka përfunduar integrimin ushtarak, gjë që është kontinuitet i politikave të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila filloi me rritjen e buxhetit, me furnizim me pajisje të reja, anëtarim në NATO dhe fuqizimin e përgjithshëm të kapaciteteve në kuadër të Armatës“.

Presidenti dhe komandanti suprem, Stevo Pendarovski para të pranishmëve në brifing shprehi kënaqësinë e tij nga profesionalizmi, përkushtimi dhe sakrifica e deri tanishme e pjesëtarëve të Armatës në ballafaqimin me pandeminë dhe me zjarret që kapluan vendin dhe theksoi se investimi në modernizimin dhe në pajisshmërinë e Armatës do të vazhdojë, gjë që do të ndikojë edhe në rritjen ekonomike dhe në standardin më të lartë të jetës së qytetarëve.

Dr. Zhanet Ristoska

Botues  
Ministria e Mbrojtjes  
së Republikës së Maqedonisë së Veriut



Kryetar i këshillit botues  
Mr. Ivan Atanasoski, kolonel

Zëvendës kryetar i këshillit botues  
Dr. Toni Petreski

Anëtarë të këshillit botues:

Lidija Jançova-Hristova

Sonja Kramarska

Afërdita Volina

Toni Janevski, nënkolonel

Liljana Petreska, nënkolonele

Violeta Kostadinova, nënkolonele

Biljana Ivanova

Dr. Zhanet Ristoska

Kryeredaktore përgjegjëse  
Dr. Zhanet Ristoska

Redaksia:

Umit Redzepe

(redaktor i artit grafik dhe teknikës),

Kristina Ilievska

(gazetare dhe fotografe),

Bujar Zylfiqari

(përkthimi dhe redaktimi në gjuhën shqipe)



MBUROJA  
Është revistë e  
Ministrisë së  
Mbrojtjes së  
Republikës së  
Maqedonisë së Veriut

Botohet një herë  
në muaj

„Orce Nikollov“ 116  
1000 Shkup

Telefon: 02 3128 276  
www.mod.gov.mk

Qëndrimet e plasura nga ana e bashkëpunëtorve të jashtëm nuk përfaqësojnë politikën zyrtare dhe qëndrimet e Ministrisë së Mbrojtjes



**PARAQIT KORRUPSIONIN**  
0800 50030

Intervistë me

# gjeneralin Fernando de la Kruz Karavaka

Komandantin e qendrës së kombinuar ajrore operative në torehon të spanjës



Gjeneral-nënkolonel Fernando De La Kruz Karavaka është komandant i Qendrës së Kombinuar Ajrore Operative në Torehon të Spanjës. Tërë karrierën e tij ushtarake ai e ka ndërtuar në kuadër të forcave ajrore të Spanjës dhe gjithësesi në kuadër të NATO-s, ku ka qenë në disa pozita të larta.

Gjenrali De La Kruz Karavaka, ishte përfaqësues zyrtar i NATO-s që morri pjesë në ngjarjen e cila u mbajt më 9 dhjetor në Shkup, kun ë praninë e kreut më të lartë shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mysafirëve të lartë nga NATO, si dhe në praninë e mediave të shumta, u realizua stërvitja me rastin e inkuadrimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të patrullimit ajror të NATO-s



### **ndaruar gjeneral, cili është misioni kryesor i misionit ajror të patrullimit në NATO?**

– Patrullimi Ajror (PA) në NATO është një pjesë vitale e mbrojtjes kolektive që mundëson sigurinë e hapësirës ajrore mbi vendet anëtare të NATO-s, 24/7. Misioni i PA të NATO-s siguron mbikqyrjen e hapësirës ajrore mbi të gjitha vendet antëtare të NATO-s, duke reaguar menjëherë me kryqëzimin gjegjësisht identifikimin kur ka nevojë për një gjë të tillë edhe në rast kur cilado fluturake e panjohur të ketë ndikim ndaj cilitdo territor të NATO-s.

### **Cili është roli i patrullimit ajror në kuadër të mbrojtjes së integruar ajrore dhe raketore të NATO-s – NATINAMDS?**

– Siç theksova paraprakisht, NATO është tërësisht i përkushtuar në mbrojtjen e hapësirës ajrore të aleatëve. NATINAMDS i mbulon të gjitha llojet e fluturakeve të panjohura që do të mund të ishin rrezik potencial për vendet aleate dhe NATO reagon në mënyrën e duhur

duke përdorur sistemin e përkatës për ballafaqim me këtë lloj rreziku. Patrullimi ajror është pjesë e NATINAMDS me anë të përdorimit të komandës dhe kontrollit ajror, me përdorimin e sistemeve për mbikqyrje dhe kontroll ajror, si dhe me fluturake për reagim të shpejtë, me ndihmën e bazave ajrore nga vendet aleate, në mënyrë që të njejtat të mund të reagojnë kundër secilit lloj të fluturakeve të panjohura në fushën e përgjegjësisë së NATO-s.

### **Duke e pasur parasysh gjendjen faktike gjeopolitike në skenën ndërkombëtare, sa janë të përfshira fluturaket e NATO-s në kuadër të operacioneve të patrullimit ajror në tokën europiane dhe cila është arsya e përfshirjes së tyre?**

– NATO, që nga fillimi ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e një reagimi të shpejtë në hapësirën ajrore, sidomos për shkak të shpejtësisë së fluturakeve. Këtë vit shënojmë 60 vjetorin e patrullimit ajror të NATO-s. Kjo do të thotë se patrullimi ajror nuk është një mision i ri. Fluturaket

e sotme mund të fluturojnë shumë shpejt dhe në këna mënyrë duhet t'a parashikojnë secilin rrezik potencial. Ne jemi të vetëdijshëm se në kuadër të NATO-s duhet të jemi të zgjuar dhe syçelë që menjëherë të reagojmë ndaj secilës fluturake të panjohur. Për të ndeshur fluturaken e panjohur, para se e njejtat të hyjë në territorin e NATO-s, duhet vazhdimisht ta ndjekim qiellin tonë. Për këtë shkak, ne jemi gjithmonë të gatshëm edhe përkundër situatës ndërkombëtare. Patrullimi ajror në kuadër apo në afërsi të hapësirës ajrore të NATO-s do të vazhdojë të reagojë ndaj secilës fluturake që nuk do të respektojë rregullat ndërkombëtare të fluturimit apo ndaj fluturakeve të panjohura që veprojnë në afërsi të kufijve të NATO-s.

### **Kush vendos se a nevojitet të ndeshemi me fluturake në një fushë të caktuar në kuadër të Aleancës dhe si zhvillohet ndeshja?**

– Të gjithë aleatët përmes të delegojnë përgjegjësinë e NATO-s, me qëllim që të identifikohet cilado fluturake e panjohur



dhe në këtë mënyrë të kemi një përgjigje të duhur duke e ndashur të njëjtën dhe duke ndjekur procedurat përkatëse. Kur do të ndodhë kjo, komandanti i qendrës përkatëse për operacione të kombinuara ajrore (CAOC) është përgjegjës për t'a angazhuar fluturaken aleate më të përshatshme në mënyrë që të ndeshet me fluturaken e panjohur në kuadër të fushës së tij të veprimit dhe përgjegjësisë. Në momentin që fluturakja do të ndeshet nga ana e fluturakes aleate për reagim të shpejt, fluturakja e identifikuar është e detyruar që të zbrapset duke e lënë hapësirën ajrore të NATO-s, ose ti kthejë rregullat civile, ose të merr mbështetje në rast se ka ndonjë urgjencë.

„Që nga viti 2020, kur Maqedonia e Veriut zyrtarisht u bë anëtare e NATO-s, kishim mundësi që t'i përshtatemi kësaj organizate përmes inkorporimit të shumë procedurave të reja, ndërsa tani më kemi arritur edhe rezultate. Duhet të jemi krenarë me punën tuaj. Jam i bindur se do të mbani të njëjtin nivel të suksesit në të mirë të gjithë vendeve“.

Gjeneral Fernando De La Kruz  
Karavaka

#### **Sipas jush, sa është e rëndësishme që të gjitha vendet e rajonit të jenë të përfshirë në misionin e NATO-s për patrullim ajror?**

– Patrullimi ajror i NATO-s demonstroi kohezionin e aleatëve për mbrojtje dhe për përgjigje ndaj çfarido kërcënimi potencial. Bashkëpunimi dhe solidariteti në këtë fushë edhe një herë dëshmojnë se NATO është aleancë e fuqishme ku asnjë vend anëtar në asnjë çast nuk është lënë vetëm. Gjithashtu personelit të fluturimit dhe kontrollorëve u mundësohet të punojnë së bashku, me anë të përdorimit të procedurave të njejta ndërmjet të gjitha vendeve aleate. Kjo është një mundësi e mirë që të njëjtët të përgatiten për pjesëmarrje në operacione, nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

#### **A ekziston sistem i trajnimit të personelit për një realizim të koordinuar të këtyre aktiviteteve?**

– Ashtu siç e cekta edhe më herët, të gjithë forcat ajrore aleate i përdorin procedurat e njejta për të vepruar në hapësirën ajrore. Patrullimi ajror është vetëm një lloj misioni. Kuptohet se ne e trajnojmë personelin tonë, jo vetëm ata të cilët punojnë në qendrën për operacione të kombinuara ajrore, por të gjithë të cilët

janë pjesë e patrullimit ajror në të gjitha vendet anëtare të NATO-s, sepse duhet patjetër të punojmë së bashku në mënyrë që të realizojmë misionin tonë. Kemi kurse të specializuara dhe stërvitje specifike në mënyrë që t'i shkathtësojmë forcat tona ajrore për të punuar së bashku si ekip në misione të ndryshme, si që është patrullimi ajror. NATO posedon ekipe të vlerësimit të cilat i vlersojnë njësitë e ndryshme dhe të cilat vërtetojnë se të njëjtët i zbatojnë procedurat e NATO-s.

#### **Cili është roli i Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të misionit të patrullimit ajror të NATO-s?**



– Republika e Maqedonisë së Veriut dhe kontribut afatgjatë në kuadër të sigurisë ndërkombëtare, me anë të forcave dhe pajisjeve. Me anëtarimin e saj në NATO, Maqedonia e Veriut ndihmoi në konsolidimin e stabilitetit dhe sigurisë për misionet e patrullimit ajror të NATO-s, për mbrojtjen e hapësirës ajrore mbi Maqedoninë e Veriut. Kjo është një shprehje konkrete e përkushtimit dhe solidaritetit të Aleancës kundrejt aleates së saj më të re për të mbrojtur territorin e saj. Ne tashmë kemi trajnuar disa ushtarë nga Maqedonia e Veriut për të qenë të gatshëm të punojnë së bashku me aleatët tjerë në këtë mision në kuadër të Qendrës për Operacione të Kombinuara Ajrore në Torehon.

#### **A është Qendra për Operacione të Kombinuara Ajrore në Torehon e përfshirë edhe në operacione tjera për sigurimin e Krahut Jugor të Aleancës?**

– Përveç patrullimit ajror, Qendra për Operacione të Kombinuara Ajrore në Torehon, si dhe secila njësi tjetër e NATO-s, bashkëpunon në aktivitete për mbrojtjen dhe ruajtjen në kuadër të fushës sonë të përgjegjësisë. Kuptohet

se ka edhe trajnime të përditshme me qëllim që të fuqizohet cilado komandë operative apo strategjike, në rast të vendosjes së ndonjë operacioni multinacional nga ana e NATO-s.

#### **Komandant De La Kruz, cilat janë sfidat e Krahut të Jugut me të cilat do të mund të ballafaqoheshim në të ardhmen e afërt?**

– Mjedisi ndërkombëtar ndryshon vazhdimisht edhe kjo mund të merret si arsye që NATO në vazhdimësi përshtatet ndaj sfidave të reja përmes përmirësimit të strategjisë së NATO-s. Vitin e ardhshëm do të kemi strategji të re për t'u ballafaquar me sfidat e reja,

edhe në sferat e reja si që janë gjithësia dhe siguria kibernetike. Këtu në jug, do të jemi të gatshëm të veprojmë së bashku me fluturaket aleate, me qëllim që të mund të ballafaqohemi me këto sfida.

Përpos misioneve tona të patrullimit ajror në kohë paqeje, ne do të përshtatim dhe do të trajnojmë njësi për tu ballafaquar me sfidat dhe kërcënimet e reja, me qëllim që të mundësojmë siguri për të gjithë vendet aleate.

Elvin Ejub





## Qendrat e përsosshmërisë së NATO-s

### Qendra e përsosshmërisë për operacione gjatë kushteve atmosferike me mot të ftohtë

**S**i rezultat i ndryshimeve klimatike globale, erdhi deri te ndryshimi edhe në kuadër të mjedisit të sigurisë, e me këtë u shfaqën edhe sfida të reja. Është karakteristike edhe rritja e interesit për hemisferën veriore nga disa popuj dhe vende të rëndësishme. Në përputhje me nevojat e NATO-s, për të vepruar edhe në kushte të vështira atmosferike, apo gjatë motit të ftohtë, në kuadër të Aleancës nevojiten disa qendra përkatëse të trajnimit dhe përgatitjes së forcave për një mjedis të këthillë.

Qendrat e përsosshmërisë (Centre of Excellence – COE) janë të orientuara në drejtim të disa fushave, në të gjitha sferat dhe për të gjitha kushtet atmosferike. NATO qendra e përsosshmërisë për operacione në kuadër të kushteve atmosferike me mot të ftohtë, gatishmëria e së cilës mjaft e rritë nivelin e efikasitetit luftarak në kushte ekstreme, gjendet në Norvegji. Si e tillë, ajo është e përqëndruar në operacione në kushte të vështira atmosferike duke bashkëpunuar ngushtë

me institucione tjera të domenit të saj, si për shembull me qendrën për luftime malore (Mountain Earfare COE), qendër kjo e cila funksionon në Slloveni. Përvoja e madhe si dhe shkathtësitë që kanë të bëjnë me motin e ftohtë, japin rezultate të kënaqshme për operacionet aktuale dhe ato vijuese të Aleancës.

Misioni i qendrës është i orientuar kah veprimi në kushte specifike të mjedisit, ndërsa njëkohësisht edhe si mbështetje

e komandës së NATO-s për transformim në përpjekjet e saj për adaptimin dhe përshtatjen e NATO-s në fushën e operacioneve në mot të ftohtë. Qendra vepron si koordinatore, ndërsa ekspertizën e saj e siguron edhe për nevojat e anëtarëve të NATO-s dhe të vendeve partnere. Kjo qendër e NATO-s ka të bëjë me një etnitet të spozoruar nacional dhe është e përbërë nga personeli me përvojë nga njësi të ndryshme norvegjeze, me



kompetencë dhe përvojë ku operacionet në mot të ftohtë janë pjesë përbërëse gjatë realizimit të detyrave dhe misionit. Drejtori i qendrës është edhe këshilltar kryesor për operacionet e Aleancës në këto kushte atmosferike. Posedon një rrjet të lidhjeve jashtëzakonisht të zhvilluar ushtarak dhe civil, si dhe lidhje kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfshirë këtu njësi dhe organizata të ndryshme. Viteve të fundit qendëra e përsosshmërisë jap mbështetje në zhvillimin dhe definimin e NATO Warfighting Capstone Concept (NWCC). Është e rëndësishme për adaptimin e dokumentit „ATP-3.2.1.5“ dhe për procedurat (Conduct of Land Tactical Operations in Cold Weather Environments) që janë në zbatim nga viti 2021. Aktivitete tjera më të rëndësishme në të cilat ka marrë pjesë qendra e përsosshmërisë për operacione në mot të ftohtë janë vijueset: mbështetje Komandës së Transformimeve në realizimin e stërvitjes Joint Ēarfare Centre (JWC) Exercise Trident Jupiter si dhe në ndërtimin e konceptit për mësimet e mësuara të vendosura në vitin 2020, jep mbështetje edhe në kuadër të Mountain Ēarfare COE në Slloveni në procesin zhvillimor me anë të përdorimit të rrjetit të vendosur kombëtar dhe aleat, vepron si udhëheqëse e grupit punues për operacione në mot të ftohtë për forcat e bashkuara ekspeditive (Joint Expeditionary Force), ndërsa në planifikimin dhe në realizimin e operacioneve i mbështet NATO stërvitjet në mot të ftohtë në Norvegji. Më pas, vepron në kuadër të shërbimit të bashkuar mjekësor në Norvegji, me qëllim të hulumtimit dhe trajtimit të lëndimeve në kushte ekstreme. Bashkëpunimi i qendrës në kuadër të projektit norvegjez për hulumtin në aspektin e performancave njerëzore gjatë motit të ftohtë vazhdon edhe në vitin 2021. Qendra e përsosshmërisë për operacione në kushte të motit të ftohtë i përfshinë kurset vijuese: kurs dimëror për instruktorë në njësitë vendore, kurs dimëror për oficerë të shtabit të NATO-s me shkathtësitë bazike ushtarake për operacione në mot të ftohtë, deri në nivel të brigadës së NATO-s, kurs për paralajmërim nga rreziku i ortekut me planifikim dhe me realizim të operacioneve në një mjedis të këthillë. Qendra vendosi plan mësimor për trajnim bazë të njësive të NATO-s në mot të ftohtë. Ky program që përbëhet nga katër anëtarë ka për qëllim të arrijë nivel ndërveprues me njësitë tjera të trajnuara për mot të ftohtë. Programi mësimor ishte qasje më e dëshiruar për njësitë e NATO-s, përfshirë këtu edhe trajnimin e tyre përr përgatitjet dhe stërvitjet në mot të ftohtë. Në këtë drejtim, njësitë e Korpusit të Marinës së SHBA-së e përdornin planin mësimor për vitin 2020 (gjithashtu të planifikuar edhe për vitin 2021), ndërsa mbajtja e një konference të NATO-s për operacione në mot të ftohtë, është planifikuar kah fundi i vitit 2021.



### Qendra e përsosshmërisë për luftë kundër mjeteve shpërthyes të improvizuara

Bashkësia ndërkombëtare është mjaft aktive në luftën kundër mjeteve shpërthyes të improvizuara (Counter - Improvised Explosive Devices, C-IED), me qëllim të fuqizimit të sigurisë së vendeve aleate dhe të të gjithë ushtarëve që janë të vendosur në teatrot e operacioneve, në drejtim të reduktimit apo eliminimit të kërcënimeve nga mjetet shpërthyes të improvizuara që i përdorin kryengritësit apo terroristët. Qendra për luftë kundër mjeteve shpërthyes të improvizuara (Counter-Improvised Explosive Devices - CIED) gjendet në Madrid të Spanjës dhe e njejtja është formuar në vitin 2010. Është formuar për një arsye të vetme, për të siguruar ekspertizë për tamera dhe për të mbështetur Aleancën dhe partnerët e saj, në mënyrë që të veprojnë në mënyrë edukative, si dhe të reduktohen dhe të eliminohen kërcënimet nga mjetet shpërthyes të improvizuara. Me një personel prej më se 60 persona, 40 prej të cilëve janë ekspertë për lëndën e materies në fushën e C-IED, qendra kryeson dhe është pjesëmarrëse

në disa grupe të punës së NATO-s dhe Agjencisë Europiane për Mbrojtje (European Defense Agency), me qëllim të krijimit të një koordinimi dhe bashkëpunimi më të mirë ndërmjet dy organizatave në kuadër të të luftarit kibernetik. Me një vizion të thjeshtë përdorë një qasje gjithëpërfshirëse me mbështetje nga personeli ushtarak, policia, bashkësia e inteligjencës, si dhe të civilëve nga bashkësia akademike, industria teknologjike dhe ajo e hulumtimit në drejtim të korret fitore ndaj terroristëve dhe rrjeteve kryengritëse të cilat përdorin mjete shpërthyes të improvizuara. Duke i pasur parasysh marrëveshjet apo kontratat standarde (STANAG 2294, STANAG 2295 и STANAG 2637), qendra jep mbështetje të procesit për zhvillimin e doktrinave për C-IED, vazhdon programin e punës së NATO-s për mbrojtje nga terrorizmi (NATO Defence Against Terrorism Program of Ēork), ofron mbështetje për NATO-n edhe në kuadër të luftës me fluturaket pa pilot si pjesë e sistemit të mbrojtjes të integruar ajror dhe raketor, ndërsa njëherit mbështet edhe avancimin e procesit për mësimet e mësuara për C-IED.

Dragan Pavlovski





## Intelegjenca artificiale e NATO-s: adoptimi dinamik, përdorimi i përgjegjshëm – pjesa e dytë

Inteligjenca artificiale është aftësia e makinerive për të kryer detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore - për shembull, njohjen e modeleve, mësimin nga përvoja, nxjerrjen e përfundimeve, bërjen e parashikimeve ose ndërmarrjen e veprimeve - qoftë në mënyrë dixhitale apo si softuer inteligjent pas sistemeve fizike autonome (shih Shkencë dhe Tendencat e Teknologjisë 2020-2040 - Anketa S&T Edge). Siç sugjerohet nga think tank RAND në raportin e „The Department of Defense Pose for Artificial Intelligence: Assessment and Recommendations (2019)“, është mire që të bëhet dallim ndërmjet tre lloje të gjera të aplikacioneve: Enterprise AI, Mission Support AI dhe Operational AI. Enterprise AI përfshin aplikacione të tilla si sistemet e menaxhimit të personelit të mundësuar nga inteligjenca financiare ose artificiale, të vendosura në mjedise të kontrolluara fort ku implikimet e dështimeve teknike janë të ulëta (përsa i përket rrezikut të afërt dhe vdekshmërisë së mundshme).

Në të kundërt, inteligjenca artificiale operacionale mund të vendoset në misione dhe operacione, dmth. në mjedise dukshëm më pak të kontrolluara dhe të tilla që implikimet e dështimit mund të jenë jashtëzakonisht të larta. Shembujt përfshijnë softuerin për kontrollin e sistemeve të palëvizshme

ose ato të automjeteve pa pilot. Mission Support AI, një terren i mesëm për sa i përket kontrollit mjedisor dhe implikimeve të dështimit, përfshin një grup të larmishëm aplikacionesh, p.sh. logjistikë dhe mirëmbajtje, ose aplikacione të lidhura me inteligjencën. Këto dallime mund të jenë të dobishme në përcaktimin



e prioriteteve, si për politikat e adoptimit ashtu edhe për parimet e përdorimit të përgjegjshëm, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të rrezikut të qenësishme në këto kategori.


Vala moderne e inteligjencës artificiale, ose vala e dytë e inteligjencës artificiale, është e fokusuar në mësimin e makinerive (ML). ML përfshin zhvillimin dhe përdorimin e algoritmeve statistikore për gjetjen e modeleve në të dhëna. Për shembull, një algoritëm klasifikimi mund të trajnohet në një grup të madh shembujsh të shënuar saktë për të përcaktuar se cilës kategori të para-ndeshur i përket objekti i ri i vëzhguar. Të mësuarit në thellësi është një nëngrup i ML, i cili përdor shtresa të shumta llogaritëse (rrjete neurale artificiale me shumë shtresa) për t'u marrë me problemet e njohjes së vështirë llogaritëse ose, për shembull, parashikimin e modelit. Rrjetet nervore konvolucionare për zbulimin e objekteve në imazhe. Imazhi 2.1 më poshtë është ilustrim i të mësuarit të thellë për identifikimin e avionëve, automjeteve dhe godinave në imazhe. ML përparon në grupe të mëdha të dhënash të sakta dhe performon dobët në grupe të vogla të dhënash ose të dhëna të pasakta. Në kushte të mira në një gamë të gjerë përdorimesh, ML tejkalon njerëzit, dhe për sa i përket performancës së parashikueshme, natyrisht, shpejtësisë, në një gamë në rritje të detyrave të ngushta për njohjen dhe parashikimin e modeleve. Kjo është arsyeja kryesore për rritjen e adoptimit të ML në fusha të gjera të veprimtarisë njerëzore.

### Drejt adoptimit dinamik

Tradicionalisht, ekonomistët e kanë modeluar prodhimin si funksion të punës dhe kapitalit (faktorët e prodhimit) dhe inputeve materiale. Për inteligjencën artificiale, faktorët e prodhimit janë talenti i specialistëve shumë të aftë dhe infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për llogaritjen dhe ruajtjen, dhe të dhënat janë kontributi kryesor. Atëherë, a është vaji i ri një e dhënë? Në thelb jo. Ndërsa të dhënat duhet të "ekstraktohen" dhe më pas "të rafinohen" përpara përdorimit të mëtejshëm, disponueshmëria e tyre rritet me volumin e daljes. Të dhënat janë gjithashtu specifike dhe jo të këmblyeshme. Për çdo rast specifik përdorimi, kërkohen grupe specifike të dhënash që përfshijnë vëzhgime të sakta përkatëse nga jeta reale (ose simulime). Për të siguruar një pikënisje



Siç u përmend në artikullin e kaluar paraprakë, NATO po përballet me një garë globale për të adoptuar teknologjinë. Forcat rivale po përdorin teknologji të reja për të arritur qëllimin e dyfishtë të konkurrencës më të madhe ekonomike, së bashku me aftësitë më të mëdha ushtarake. Aleatët përballen me një sërë sfidash ndërsa përpiqen të përfitojnë nga teknologjitë e reja dhe të përshpejtuara. Këto sfida bazohen në dy shtylla të ndërlidhura të punës: sigurimin e adoptimit dinamik të teknologjive të reja dhe menaxhimin e përgjegjshëm të tyre. Inteligjenca artificiale (AI) është në qendër të këtyre të menduarit





solide, institucionet e mbrojtjes aleate do të duhet të sigurojnë dixhitalizimin e tyre të mëtejshëm. Në përgjithësi, politika e të dhënave duhet të adresojë të gjithë zinxhirin e vlerës, i cili përfshin mbledhjen, aksesin, ndarjen, ruajtjen, metadatat, dokumentacionin, kontrollin e cilësisë (duke përfshirë pastrimin dhe

zbutjen e të dhënave) dhe proceset për të siguruar përputhjen me kërkesat ligjore. Masat mbështetëse për faktorët e prodhimit - talenti dhe infrastruktura - duhet të përfshijnë burime njerëzore dhe politika të shëndetshme dhe fleksibël për lidhjen e kontratave për të tërhequr dhe ushqyer talentin më të mirë njerëzor, si

dhe vendosjen e pajisjeve kompjuterike dhe të ruajtjes së të dhënave përkatëse dhe të sigurt.

Tjetra ka të bëjë me produktivitetin. Gjatë shekujve, aktorët ekonomikë kanë kërkuar mënyrat më të mira për të kombinuar faktorët e prodhimit: A janë ata plotësues? A janë të zëvendësueshme? Cilat kombinime sjellin rendimentin më të lartë? Cilat procese dhe praktika të prodhimit dhe menaxhimit japin rezultatet më të mira? Për inteligjencën artificiale, megjithëse në një farë mase ka kompromise, faktorët e prodhimit janë shumë më plotësues: nevojiten investime të konsiderueshme në të tre faktorët për të pasur sukses.

Për sa i përket proceseve dhe menaxhimit, praktika më e mirë e industrisë së softuerit sugjeron që zhvillimi dhe shpërndarja e zgjidhjeve të inteligjencës artificiale duhet të mbështetet në qasjet Agile, në vend të modelit tradicional të Waterfall. Kjo



Të mësuarit e thellë mund të përdoret për zbulimin e objekteve specifike në imazh.

(: Hoeyer, T.; Kuenzer, C. Открывание на объекты и сегментация на слики со të mësuarit e thellë të të dhënave për hulumtim të Tokës: Shqyrtim-Pjesa e I: Evolucion dhe trendet e periudhës së kaluar të afërt. Remote Sens. 2020, 12, 1667.)

përfshin procese shumë dinamike dhe përsëritëse, duke filluar me një deklaratë fillestare dhe fleksibël të problemit, në vend të një deklarate të detajuar dhe të ngurtë të kërkesave. Ka disa variante të Agile në industri dhe disa nga këto variante zbatohen në mënyrë aktive në disa komunitete të NATO-s.

**Përkushtim ndaj përdorimit të përgjegjshëm**

Suksesi i Aleancës me inteligjencën artificiale do të varet gjithashtu nga parimet dhe praktikatat e reja dhe të mirë-projektuara në lidhje me qeverisjen e mirë dhe përdorimin e përgjegjshëm. Disa qeveri aleate kanë marrë tashmë disa përgjegjësi publike në fushën e përdorimit të përgjegjshëm, duke trajtuar koncepte të tilla ndër të tjera si ligjshmëria, llogaridhënia, konfidencialiteti dhe qeverisja. Paralelisht, aleatët morën pjesë në Grupin e Ekspertëve

të Qeverisë për Sistemet e Armëve Autonome Vdekjeprurëse nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, gjë që çoi në formulimin e 11 parimeve udhëzuese. E rëndësishmja, ka një shans të mirë që puna e adoptimit të inteligjencës artificiale dhe puna e parimeve të përdorimit të përgjegjshëm të shihen si plotësuese dhe sinergjike. Në fakt, ekzistojnë disa parime apo synime thelbësore që do të mbështesin dhe lehtësojnë praktikatat e mira inxhinierike, si dhe sjelljen e përgjegjshme të shtetit. Disa parime kombëtare nënkuptojnë nevojën për kërkesa specifike të projektimit. Për shembull, parimi i menaxhueshmërisë mund të lidhet me aftësitë teknike për të zbuluar dhe shmangur efektet negative dhe për të përjashtuar ose çaktivizuar në rast të sjelljes së paqëndrueshme. Karakteristikat teknike të nevojshme për të siguruar që këto dhe objektiva të tjerë janë përmbushur do të jenë

domosdoshmërisht pjesë e fazave të projektimit dhe testimit të sistemeve përkatëse. Nga ana tjetër, puna përkatëse inxhinierike do të jetë një mundësi për të përmirësuar të kuptuarit, duke çuar në parime më të pjesëshme dhe më të pjekura. Puna e mëtejshme në fushën e testimit, vlerësimit, verifikimit dhe vërtetimit (TEVV) do të jetë thelbësore, si dhe mbështetje nga përpjekjet përkatëse të modelimit dhe simulimit. Forcat e standardizimit të krijuara mirë të NATO-s do të ndihmojnë në harmonizimin e këtyre linjave të përpjekjeve duke siguruar ndërveprimin midis forcave aleate. Në ndërkohë, parimet gjithëpërfshirëse, si ato të zhvilluara në disa raste kombëtare, si dhe nën kujdesin e OKB-së, ofrojnë një bazë për konsultime të mëtejshme midis aleatëve, si dhe pika referimi në lidhje me qëndrimet ekzistuese kombëtare.

Dr. Aleksanar Petrovski

# Nën flamurin e OKB-së

## Vendosja e misionit paqeruajtës



**M**enaxhimi i krizës dhe misionet paqeruajtëse zakonisht krijohen pas një procesi të gjatë dhe kompleks. Në atë proces merret parasysh natyra e krizës dhe të gjithë faktorët që ndikojnë në zgjidhjen e konfliktit, si dhe strukturat dhe mekanizmat e nevojshëm që do të arrinin qëllimin. Megjithatë, ekzistojnë parime dhe baza të përbashkëta që përcaktojnë përgjithësisht rrjedhën e një misioni paqeruajtës. Këto parime dhe mekanizma ndryshojnë në procedurat e OKB-së dhe BE-së në krijimin e një misioni paqeruajtës.

Mandati i misionit është baza ligjore mbi të cilën bazohet çdo mision. Përpara se të përcaktohet mandati, tashmë janë rënë dakord detajet e nevojshme ndërmjet vendeve pjesëmarrëse të interesuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. OKB-ja njofton operacionet e saj paqeruajtëse përmes rezolutave të Këshillit të Sigurimit. Këto rezoluta zakonisht miratohen në bazë të konsensusit dhe kompromisit ndërmjet shteteve anëtare. Pothuajse të gjitha operacionet paqeruajtëse të organizatave rajonale kryhen nën një mandat të OKB-së. Baza ligjore për çdo mision të BE-së sipas Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit (EUSDP) lind nga vendimet e Këshillit të BE-së që

“Helmetat blu” zakonisht vendosen në zona ku nuk ka paqe. Kjo në vetvete është një sfidë kur bëhet fjalë për formulimin e detyrave prioritare për misionin, veçanërisht për përpjekjet për mbrojtjen e qytetërimit

pasojnë ose me ftesë të vendit pritës ose me një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe përmbajnë mandate të dakorduara për misionin.

### Vendosja e misionit paqeruajtës - OKB

Faza 1. Konsultimet parësore – Ashtu sië ndryshon një konflikt në intensitet ose arrin kulmin dhe largohet nga gjetja e një zgjidhjeje, po ashtu OKB-ja intensifikon konsultimet për të përcaktuar përgjigjen e



saj ndaj konfliktit. Këto konsultime mund të përfshijnë një numër aktorësh brenda OKB-së, qeverive, partive, shteteve anëtare që mund të kontribuojnë me trupa dhe me polici, si dhe me OJQ rajonale dhe me organizata të tjera.

Faza 2. Vlerësimi strategjik dhe planifikimi parësor – Në rast se pas konsultimeve fillestare, merret në konsideratë kryerja e një operacioni paqeruajtës ose një misioni të posaçëm politik, atëherë krijohet një Task Forcë e Integruar, që mbulon departamentet, fondet dhe programet përkatëse të OKB-së. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së nxjerr një Direktivë Planifikimi, në rast nevoje për udhëzime të nivelit të lartë të nevojshëm për të filluar procesin e planifikimit, ndarjen e përgjegjësisë, koordinimin dhe raportimin. Menjëherë më pas, bëhet një vlerësim strategjik, bazuar në Politikën e Integruar të Vlerësimit dhe Planifikimit të OKB-së. Vlerësimi strategjik është procesi analitik që përfshin: analizën e konfliktit,

përcaktimin e prioriteteve për ruajtjen e paqes dhe identifikimin e opsioneve për angazhimin e OKB-së. Vlerësimet teknike mund të bëhen gjithashtu për të sqaruar aspektet thelbësore dhe operacionale të mbështetjes së misionit. Nëse kushtet e sigurisë, koha dhe burimet e disponueshme e lejojnë, vlerësimi strategjik dhe teknik bëhet në terren. Bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimeve, planifikuesit formulojnë një koncept fillestar dhe përgatisin raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për Këshillin e Sigurimit, me propozime për angazhimet e mundshme të OKB-së, duke përfshirë krijimin e një misioni të OKB-së në vendin pritës.

Faza 3. Revolucioni i Këshillit të Sigurimit – Në rast se një mosmarrëveshje ose konflikt konsiderohet një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mund të miratojë një rezolutë që miraton sanksionet ose

vendos një operacion paqeruajtës. Pas mbledhjes së të dhënave nga vlerësimet strategjike dhe teknike në terren, Këshilli i Sigurimit miratoi gjithashtu një mandat dhe fushëveprim specifik për operacionin paqeruajtës. Gjatë operacionit paqeruajtës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së informon rregullisht Këshillin e Sigurimit mbi progresin dhe propozon rregullime të mandatit të misionit deri në fund të misionit.

Faza 4. Emërimi i zyrtarëve – Për të udhëhequr një operacion paqeruajtës (ose mision të posaçëm politik), Sekretari i Përgjithshëm do të emërojë një Shef të Misionit dhe një Përfaqësues Special (PSSP), i cili do t'i raportojë Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu emëron komandantin e forcës dhe shefin e policisë për të komanduar operacionin paqeruajtës, ndërsa PSSP-ja është përgjegjës për vendosjen civile të operacionit paqeruajtës. Departamenti i OKB-së për Operacionet Paqeruajtëse gjeneron personel aktiv policor dhe ushtarak, si dhe oficerë të veçantë të stafit, vëzhgues dhe oficerë policie.

Faza 5. Plan i misionit – Pas dhënies së mandatit të misionit, Sekretari i Përgjithshëm i lëshon një direktivë PSSP-së për të ofruar udhëzime në nivel strategjik, duke vendosur prioritetet për ruajtjen e paqes, duke përcaktuar bazën organizative për praninë e OKB-së, rolet, përgjegjësitë dhe koordinimin, si dhe parametrat e planifikimit.

Me shpërndarjen e direktivës tek PSSP-ja, përgjegjësia për planifikimin e mëtutjeshëm bartet në terren. Me këtë, PSSP-ja është përgjegjëse për ofrimin e udhëzimeve të politikave për zbatimin e mandatit dhe udhëheqjen e procesit të planifikimit në nivel operacional. Kjo përfshin finalizimin e koncepteve të komponentëve individualë të misionit dhe zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës të misionit. Plani i misionit përmban: kontekstin, parimet për zbatimin e mandatit, objektivat e misionit, prioritetet, supozimet dhe rreziqet kryesore, fazat e misionit, udhëzimet për komponentët individualë, parimet e koordinimit dhe implikimet, për burimet në dispozicion.

Vendosja e misionit paqeruajtës – BE Faza 1. Definimi i bazës së angazhimit – Pasi të jetë identifikuar një krizë, Komiteti i Politikës dhe Sigurisë dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë nisin një përgjigje të BE-së ndaj krizës. Kjo fazë përfshin Grupin e Parandalimit të Konfliktve dhe Bordin e Menaxhimit të Krizave, të cilët krijojnë bazën për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm. Bordi i Menaxhimit të Krizave menjëherë



shpërndan udhëzime të brendshme për veprime dhe planifikim të mëtejshëm dhe inicon krijimin e një Kornizë Politike për Menaxhimin e Krizave. Korniza përcakton kontekstin politik të krizës, duke përcaktuar se çfarë është kriza, pse BE-ja duhet të veprojë dhe cilat instrumente janë të disponueshme dhe të përshtatshme në përgjigje të BE-së (sanksionet ekonomike, aktivitetet diplomatike, ndërmbetësimi, ndihma humanitare, ndihma për zhvillim, etj. Faza 2. Përcaktimi i qëllimeve dhe formës së misionit – Koncepti i Menaxhimit të Krizave është përgatitur nga Drejtoria për Qasje të Integruar në Siguri dhe Paqe, në konsultim me të gjitha drejtoritë dhe shërbimet përkatëse të Bashkimit, në veçanti me Shtabin Ushtarak të BE-së. Mekanizmi financiar Athena është aktivizuar për operacione ushtarake. Drejtoria për Akses të Integruar në Siguri dhe Paqe dërgon menjëherë një mision në zonën e krizës, me qëllim zbulimin e fakteve, konfirmimin e vullnetit të autoriteteve lokale për zgjidhjen e krizës dhe zhvillimin e një koncepti për menaxhimin e krizave. Qëllimi i Konceptit është të analizojë dhe propozojë opsione për reagim ndaj krizës, duke përcaktuar qëllimet dhe objektivat strategjike dhe qëllimin e misionit të BE-së. Një koncept i tillë miratohet nga Këshilli i BE-së. Në varësi të kompleksitetit të krizës, po zhvillohen opsione strategjike civile dhe ushtarake. Komiteti për Çështjet Civile të Menaxhimit të Krizave dhe Komiteti Ushtarak i BE-së vlerësojnë opsionet e mundshme civile dhe ushtarake për reagim ndaj krizave dhe këshillojnë Komitetin e Politikës dhe Sigurisë, pas së cilës Komandanti i Operacionit Civil është udhëzuar të fillojë planifikimin e operacionit, duke krijuar ekipet e nevojshme dhe planifikimi i shtabit të ardhshëm operativ ushtarak. Më pas Këshilli merr Vendim për përcaktimin e misionit (operacionit). Me këtë procedurë përcaktohen qëllimet dhe mandati i misionit. Pas kësaj, vendet e treta ftohen të marrin pjesë në mision dhe të ofrojnë kontributin e tyre. Në të njëjtën kohë po përgatitet edhe struktura financiare e operacionit.
Disa ditë më vonë, Komanda e Brigadës së Europës Juglindore (South-Eastern Europe Brigade-SEEBRIG) me seli në Kumanovë, dha donacion për spitalin e Kumanovës. Donacionin e dorëzuan pjesëtarët e brigadës të cilët personelit i dëshiruan shëndet dhe suksese si dhe durim e fuqi në ballafaqimin me pandeminë. “Jemi këtu për të dhënë një donacion simbolik për spitalin e Kumanovës dhe në këtë mënyrë të shprehim mirënjohjen tonë deri tek mjekët dhe motrat medicinale të cilat përgjatë dy viteve të kaluara ofrojnë ndihmën e tyre për të gjithë shoqërinë në ballafaqimin me pandeminë COVID-19. Duket se pandemia nuk do të përfundojë në të ardhmen e afërt dhe se jeta me të u bë një normalitet për ne. Ju dëshiroj që si personel mjekësor të qëndroni të fortë dhe të sigurt dhe të vazhdojnë të ndihmojnë shoqërinë, duke u dëshiruar gjithë të mirat për festat vijuese me shumë shëndet, paqe dhe mirëqenie” – tha gjenerali i brigadave Iliopoulos. Drejtoresha e spitalit, Snezhana Zaharieva, u falenderua për donacionin dhe rikujtoi se vitin e kaluar, komanda ka dhënë donacion pajisje për mbrojtje personale për personelin mjekësor në spital. “Vitin e kaluar morëm pajisje për mbrojtje personale, ndërsa sivjet kemi marrë aparatën EKG si dhe dy aparate tjerë për matje joinvazive të shtypjes së gjakut. Falenderim deri te pjesëtarët e brigadës, ky është një gjest i mirë në vigjile të festave, ndërsa për ne gjithsesi një donacion i mirëseardhur, sepse këto janë aparate të cilët ne i blejmë çdo vit, port ë gjithë e dimë se në një periudhë të rritjes së nivelit të punës, kemi shumë nevojë për furnizim me të njejtat.” Theksoi Zaharieva.

Aleksandra Maksimovska

## Shnohet Dita e Batalionit të Renxherëve

**P**jesëtarët e Batalionit të Renxherëve me solemnitete ushtarake në kazermën “Ilinden” shënuan ditën e formimit të njësisë. Në këtë solemnitete në të cilën morri pjesë edhe ministrja e mbrojtjes Radmilla Shekerinska, zëvendësministri i mbrojtjes Bashkim Hasani, sekretari shtetëror i Ministrisë së Mbrojtjes Dragan Nikoliq, si dhe komandantë të njësisë të stacionuara në kazermën “Ilinden”. Para të pranishmëve fjalë rasti mbajti zëvendës shefi i SHP, gjeneral-majori Azim Nuredin. Në fjalën e tij, gjenerali Nuredin theksoi se Batalioni i Renxherëve është njësi e cila në fillim ishte në përbërje të Njësisë për Operacione Speciale, e më pas e transformuar në Regjiment për Operacione Speciale, ndërsa në përputhje me strukturën e re është në nivelin e një batalionit të pavarur dhe duhet të transformohet në batalion zbulues-kundërzbulues. Njëherit, gjenerali tha: “Sot

kur e festojmë ditëlindjen e 18, mund të krenohemi me sukseset e njësisë, me rezultatet dhe me mirënjohjet për detyrat e shumta të realizuara me sukses në kuadër të misioneve në Irak dhe në Afganistan, si dhe me kurset dhe me trajnimet e përfunduara dhe me pjesëmarrjen në stërvitje dhe aktivitete stërvitore në vendin tonë dhe jashtë tij”. Të gjitha këto, janë dëshmi të cilat e vërtetojnë rëndësinë e kësaj njësie për Armatën dhe për vendin”. Komandanti i renxherëve, nënkoloneli Mentor Saiti, në fjalën e tij u ndal te fillimet e formimit të kësaj njësie duke thënë se ia dolëm që ti kalojmë të gjitha sfidat dhe në këtë mënyrë t’a ruajmë frymën, profesionalizmin, lojalitetin dhe standardet, e para se gjithash, dinjitetin e “renxherëve”. Gjithashtu, ai tha se pjesëtarët duhet që në mënyrë të përkushtuar të vazhdojnë në rrugën e sukseseve të cilat me vite i trasojnë si



ushtarakë vërtetë të guximshëm, duke u prirë nga motoja e tyre: “Gjithmonë një hap përpara”. Pjesëtarët e Batalionit të Renxherëve (BR) në vigjile të ditës së njësisë, organizuan aksion për dhurimin e gjakut, aksion humanitar në të cilën dhuruan shtojcën e ushqimit të tyre për fëmijët e vendosur në kampusin e nxënësve të shkollës “Goce Dellçev” në f. Lubanci. Gjithashtu, u organizuan edhe gara sportive të renxherëve dhe u organizua edhe ditë e hapur në kazermën “Ilinden”, e me këtë rast, fituesit iu nda edhe mirënjohje.

## Kampionati i 13. i Armatës në vrapim kros kantri

Në këtë kampionat, në shtegun pranë qendrës sportive “Hipodrom”, në distancë prej 8000 metrave në konkurrencën e meshkujve dhe në 4800 metra në konkurrencën e femrave, morën pjesë 130 pjesëtarë të Armatës, si dhe pjesëtarë të Federatës së Atletikës së Maqedonisë. Shefi i sekcionit për stërvitje dhe trajnim, koloneli Vladimir Stojanovski, i cili mbajti fjalim me rastin e hapjes së kampionatit, potencoi rëndësinë e sportit në kuadër të Armatës, sidomos të atletikës, si disiplinë në të cilën arrihen rezultatet më të mira. Më e suksesshme në konkurrencën e femrave ishte Marija Pelikon, vendi i dytë

i takoi rreshteres së vjetër të klasit të parë, Irena Lekoskës, ndërsa si e treta u rradihi kadetja Bllagica Stefanovska. Në garën ekipore, më të mirat në konkurrencën e femrave ishin pjesëtarët e Komandës për Trajnim dhe Doktrina, të dytat u rradihen pjesëtarët e VING-ut ajror, ndërsa vendi i tretë ishte i rezervuar për Batalionin e 2 të Këmbëtorisë. Në konkurrencën e meshkujve, vendi i parë i takoi Millosh Rançiqit, vendi i dytë u rezervua për kapetanin Zhan Tosevin ndërsa si i treti përfundoi Trajçe Iljevski. Në garën ekipore, pjesëtarët e Batalionit të Forcave Speciale e morën vendin e



parë, të dytët përfunduan pjesëtarët e Batalionit të Nderit, ndërsa vendi i tretë i takoi Batalionit të 2 të Këmbëtorisë. Pas përfundimit të garave, individëve dhe ekipeve më të suksesshme iu ndanë medalje dhe kupa.

## Popullarizim i profesionit ushtarak

**P**ërfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me ushtarë profesional, nënoficerë dhe oficerë të Armatës, filluan me realizimin e projektit për popullarizimin e profesionit ushtarak. Ata në disa shkolla të mesme në Shkup, Kriva Pallankë, në Kërçovë, si dhe në Makedonski Brod, i informuan nxënësit e shkollave, për atë se çfarë do të thotë të qenurit pjesëtarë i Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kushtet e pranimit në shërbim, si ata mund të bëhen pjesë e Armatës dhe cilat janë përfitimet e profesionit ushtarak. Në kuadër të ligjeratave të cilat janë të planifikuara në kuadër të këtij projekti, të rinjtë do të njihen me obligimet dhe me përfitimet e shumta që i ofron Armata, me qëllim të rritjes së nivelit të interesimit të tyre për të kokuruar në konkursat dhe shpalljet për ushtarë profesional, ku do të rritet edhe niveli i cilësisë së pjesëtarëve të ardhshëm të Armatës. Numri në rritje i konkurentëve dhe atyre që konkruojnë në shpalljet publike për kadetët pranë

Akademisë Ushtarake “Gjeneral Mihajlo Apostolli” në Shkup është me rëndësi të jashtëzakonshme, në mënyrë që të mbahet niveli i lartë i cilësisë të oficerët dhe të liderët e ri të Armatës. Ky projekt filloj me realizim në shkollat e mesme vijuse: “Josip Broz Tito” dhe “Rade

Jovçevski-Korçagin” në Shkup, “Gjorçe Petrov” në Kriva Pallankë, “Drita” në Kërçovë, dhe “Shën Naumi i Ohrit” në Makedonski Brod. Ky projekt do të zgjasë deri në fund të muajit shkurt gjatë vitit të ardhshëm dhe do të realizohet në më shumë shkolla të mesme në tërë vendin.





# Promovim i nëntogerëve dhe betim solemn i kadetëve të rinj

**N**ë solemnitetin me rastin e promovimit të oficerëve të rinj të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me rastin e dhënies së betimit solemn të gjeneratës së re të kadetëve pranë Akademisë Ushtarake, morri pjesë edhe presidenti dhe njëherit komandanti suprem i forcave të armatosura, Stevo Pendarovski, ministrija e mbrojtjes Radmilla Shekerinska, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, gjeneral-nënkolonel Vasko Gjurginovski, zëvendësministri i mbrojtjes Bashkim Hasani, zëvendës shefi i SHP, sekretari shtetëror i Ministrisë së Mbrojtjes, gjeneralë të Armatës, ambasadorët e Malit të Zi dhe të Kosovës, përfaqësues të MM-së së Bosnje e Hercegovinës, Kosovës dhe Malit të Zi, decani i Akademisë Ushtarake, komandantë të njësive të Armatës, familjarë dhe të afërm të kadetëve, si dhe mysafirë tjerë. Presidenti dhe njëherit komandanti suprem i forcave të Armatësura të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski në fjalën e tij deri te kadetët, tha: “Duke e zgjedhur këtë profesion, ju kadeët si dhe studentët e ardhshëm, rreshtoheni pas një kauze fisnike. Pranë Akademisë Ushtarake “Gjeneral Mihajllo Apostolski” ju do të mund ti sëndërtoni njohuritë tuaja për konceptet bashkëkohore të mbrojtjes, por gjithashtu edhe t’i avanconi vlerat tuaja njerëzore, etika dhe morale, të nevojshme për secilin lider me integritet

Në Akademinë Ushtarake “Gjeneral Mihajllo Apostolski” në Shkup me një solemnitet rasti u promovuan oficerët e rinj të Armatës në gradën e nëntogerit të klasës së 21, ndërsa betim solemn dhanë kadetët e rinj të klasës së 25 pranë Akademisë Ushtarake.

dhe lider të ndershëm”. Njëherit presidenti Pendarovski duke iu drejtuar nëntogerëve të rinj të posa pranuar, tha: “Kjo është një ditë e madhe edhe për të gjithë ju të cilët jeni të promovuar si nëntoger. Grada e oficerit do të thotë nder, dinjitet dhe përgjegjësi ndaj Armatës dhe ndaj atdheut. Ne presim nga ju që të sjellni një energji, shkathtësi dhe njohuri të reja në strukturat e Armatës dhe të gjithë njohuritë e fituara gjatë katër viteve të kaluara, t’a zbttoni në kuadër të komandave dhe njësive, ku edhe do të kontribuoni në fuqizimin e gjendjes së gatishmërisë dhe moralit të Armatës”.

Në kuadër të solemnitetit, tre kadetëve të parë, Rexhep Mustafovskit, Illço Gjorgievskit dhe Damjan Angjellovskit, nga ana e presidentit Pendarovski, ministres Shekerinska dhe gjeneralit Gjurginovski, iu ndanë dhuratat përkatëse për rezultatet dhe suksesin e arritur. Nga klasa e 21. e oficerëve u promovuan 31 nëntoger të cilët do të vazhdojnë të ndërtojnë karrierën e tyre në njësitë e Armatës, ndërsa po aq kadetë të klasës së 25., me anë të dhënies së betimit solemn, fillojnë mësimin katër vjeçarë të ciklit të parë të studimeve pranë Akademisë Ushtarake.



## U shpërblyen pjesëtarët e Armatës të cilët ishin pjesë e ballafaqimit me zjarret

**P**jesëtarët e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët ishin pjesë e aksionit për shuarjen e zjarreve të cilët këtë verë e kapluan vendin, morrën shpërblime. Nga ana e ministres së mbrojtjes u ndanë shpërblime dhe masa stimulative për pjesëtarët e Armatës, për ushtarët, nënoficerët, oficerët, të cilët gjatë zjarreve, me anë të makinave ushtarako-inxhinerike, me mekanizim dhe me helikopterë nga VING-u ajror, pa rezervë, në mënyrë profesionale dhe me guxim u angazhuan për t'u ndihmuar qytetarëve në shuarjen apo fikjen e zjarreve. Armata ndihmoi në fikjen e zjarreve në 13 lokacione nëpër Maqedoninë e Veriut – në rajonin e

Koçanit, Dellçevës, Pehçevës, në fshatin Istvenik, Robovë dhe Umlenë, në rajonin e Vallandovës, Prilepit, Pletvarit, në fshatin Toplicë, në Staro Negoriçane dhe në Ovçe Pole.

Në konferencën për shtyp në gushtin e sivjemë me rastin e angazhimit të Armatës në ballafaqimin me zjarret, ministrja Shekerinska deklaroi: "Pa u kursyer, pa rezerva, pa kalkulime, Armata doli për qytetarët dhe për shtetin e saj"... Asnjëri prej pjesëtarëve të saj nuk parashtrroi pyetje, asnjëri nuk u fsheh, asnjëri nuk shkoi te më e vështira, por të gjithë ishin të pranishëm, ishin vazhdimisht të pranishëm. Të gjithë i meritojnë vlerësimet më të larta dhe lëvdatat, sepse atë që



ata bënë, ishte me të vërtetë heroizëm", tha atëherë ministrja Shekerinska duke pororsitur: "Unë si ministre e mbrojtjes ndjej nevojë që t'ju falenderohem të gjithëve dhe t'ju them se as unë, por as shteti këtë vepër nuk do t'a harrojë". Shpërblimet dhe masat stimulative që u paralajmëruan në Ditën e Armatës nga ana e ministres Shekerinska, pjesëtarëve të Armatës iu ndanë për ballafaqimin e suksesshëm me zjarret.

## Mirënjohje dhe medalje për pjesëmarrësit në rotacionin e fundit të misionit "Përkrahje e Vendosur"

**P**jesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët ishin pjesë e rotacionit të fundit të misionit "Përkrahje e Vendosur", me një ceremoni solemne iu ndanë mirënjohje dhe medalje nga ana e Forcave të Armatosura të SHBA-së, për pjesëmarrjen në misionin "Përkrahje e Vendosur" Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, gjeneral-majori Azim Nuredin, zëvendësministri i mbrojtjes, Bashkim Hasani si dhe atashu ushtarak i SHBA-së, koloneli Piter Rovell të cilët ua ndanë mirënjohjet gjashtëmbëdhjetë pjesëtarëve të Armatës, e ceku kontrinutin të cilin e dhanë në kuadër të këtij misioni në të cilën morrën pjesë nga fillimi i tij, si dhe profesionalizmin e demonstruar gjatë

realizimit të detyrave. Paraprakisht, nga ana e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, gjeneral-nënkolonelit Vasko Gjurçinovski, pjesëtarëve të Armatës gjithashtu ju shprehën urata për mirënjohjet e fituara. Medaljet për pjesëmarrje dhe për përkushtim të pjesëtarët e regjimentit për siguri në mision si dhe përfaqësuesi më i vjetër komëbtar, ndahen nga ana e Forcave të Armatosura të SHBA-së, në përbërjen e të cilëve edhe kontingjenti jonë i realizonte detyrat nga dhjetori i vitit 2020, deri në qershor të vitit 2021, ishte edhe rotacioni i fundit në përputhje me vendimin e NATO-s për përfundimin e angazhimit të forcave në Afganistan.

Operacioni paqësor i kryesuar nga NATO



"Përkrahje e Vendosur", mision ky pasues i misionit ISAF, filloi më 1.1.2015 dhe në të ne morrën pjesë që nga dita e parë. Kontributi ynë në kuadër të operacionit ishte me anë të personelit të shtabit, njësia e sigurimit dhe monitorimit në bashkëpunim me forcat e SHAB-së dhe të Republikës së Turqisë, ndërsa në rotacionin e fundit morën pjesë me ekip mjekësor dhe kirurgjik në kuadër të përbërjes së kontingjentit norvegjez.

## Mirënjohje dhe masa simulative për pjesëtarët e Batalionit të Forcave Speciale

**S**hefi i SHP të Armatës, gjeneral-nënkoloneli Vasko Gjurçinovski, u shprehu mirënjohje dhe u ndau masa simulative pjesëtarëve të Batalionit të Forcave Speciale (bFS), që me anë të vlerësimit të suksesshëm, i arritën qëllimet e paracaktuara të shkathhtësisë për forcat speciale, pas anëtarimit tonë në NATO. Pjesëtarët e bFS me dy elemente luftarake për operacione speciale, nga periudha kohore prej 29 nëntorit deri më 2 dhjetor, morën pjesë në vlerësimin e forcave speciale (SOFEVAL), që u realizua në kuadër të stërvitjes së NATO-s në Republikën e Greqisë. Të njëjtët u notuan gjegjësisht u vlerësuan me notën "në gjendje gatishmërie", ku bFS, realizoi njërin ndër qëllimet e shkathhtësisë së Armatës në domenin e forcave speciale të cilat janë të paracaktuara pas anëtarimit tonë në NATO. Gjenerali Gjurçinovski, duke iu drejtuar pjesëtarëve të pranishëm të Batalionit të Forcave Speciale, theksoi se rezultati i arritur përgjatë vlerësimit nga ana e NATO-s, i cili u realizua në Republikën e Greqisë dhe nga ana e NATO vlerësuesve është i denjë për respekt, sepse kjo është përbërja e parë e cila pas pranimit tonë në NATO i ka përmbushur kritaret strikte që kërkohen në kuadër të vlerësimit. Me këtë rast, ai i porositi pjesëtarët që të vazhdojnë me intenzitet të vazhdueshëm që njohuritë e tyre t'i investojnë dhe të japin kontributin e tyre në gatishmërinë gjithpërfshirëse të Armatës, por edhe përmes shembullit personal për t'i inkurajuar pjesëtarët e njësive tjera të cilët gjithashtu i presin vlerësimet parësore në përputhje me standardet e NATO-s. Njëherit gjenerali Gjurçinovski e



shfrytëzoi rastin që të informojë rreth proceseve të Armatës që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të jetës dhe të punës, si dhe të jep rekomandime për angazhimin e mëtejshëm profesional të kësaj njësie elite, ku edhe vet i ka filluar hapat e para në karrierën e tij. Komandanti i bFS, nënkoloneli Oliver Zariovski theksoi se motoja e njësive "Gjithmonë të parët", vërtetohet jo vetëm për faktin se kjo është përbërja e parë profesionale, por edhe se gjithmonë është në rradhët e para, gjë që dëshmon edhe tani si përbërje e parë që është vlerësuar sipas standardeve të NATO-s pas anëtarimit tonë të plotë në NATO. Gjatë vizitës së zëvendës shefit të SHP që u bëri pjesëtarëve të Batalionit të Forcave Speciale, ai ua transmetoi masat stimulative të ndara nga ana e shefit të Shtabit të Përgjithshëm për nivelin e arritur të vlerësimit – nivel i lartë i gatishmërisë.



# Në Armatë janë pranuar





**M**ë 22 dhjetor në kazermën "Aleksio Demnievski-Bauman" në Veles u mbajt ceremoni solemne për pranimin e 100 ushtarëve profesional në rradhët e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në kokursin e publikuar konkurruan 895 kandidatë, ku edhe njëherë u dëshmuar interesimi i madh i cili gjatë katër viteve të fundit vazhdimisht është në rritje, për shkak të kushteve më të mira për punë. Në këtë ceremoni, fjalë rasti mbajti edhe ministrja e mbrojtjes, Radmilla Shekerinska. Duke i uruar ushtarët për pranimin e tyre, ajo mes tjerash tha se ata janë njëqind ushtarët e parë të cilët bëhen pjesë e Armatës pas integritit të plotë ushtarak në NATO. „Për ju kjo është krenari, ndërsa për ne përgjegjësi për të bërë gjithçka që duhet, në mënyrë që ju të jepni maksimumin tuaj. Sot me krenari mund të themi se secili pjesëtar i Armatës posedon dy komplete të uniformës ushtarake, çizme, pajisje sportive, siguroam edhe pajisje për alpinizëm, ABHO pajisje si dhe kemi hyrë në procesin e modernizimit të Armatës me automjete të reja të blinduara dhe me armatim modern” tha ministrja Shekerinska. Ministrja gjithashtu tha se Armata, përpos NATO-s, është e rëndësishme edhe për

# 100 ushtarë profesional



anëtarimin në BE. “Armata dhe mbrojtja nuk janë të rëndësishme vetëm për anëtarimin tonë në NATO, por edhe për anëtarimin në BE, që është gjithashtu prioritet i jonë strategjik. Dje Qeveria e dëshmoi se Maqedonia e Veriut do të përfshihet në grupin multinacional luftarak të BE-së i stacionuar në Greqi, HELBROC, që është pjesë e politikës së përbashkët të mbrojtjes dhe të sigurisë së BE-së në të cilin do të japin kontribut me një regjiment të lehtë të këmbësorisë. Me këtë ne dëshmojmë se ambiciet tona nuk kanë përfunduar me anëtarimin në NATO, por përkundrazi, ato janë rritur dhe se do të jemi një argument plotësues edhe për anëtarimin tonë në BE”, nënvizoi ministrja. Ajo mes tjerash theksoi se me anëtarimin në NATO janë rritur avantazhet për Armatën. „Na u hapën dyert ndaj një potenciali të madh dhe përsosjes në kuadër të shërbimit dhe unë jam e bindur se këtë do t’a shfrytëzojnë të gjithë pjesëtarët e Armatës. Do të keni mundësi që të merrni pjesë në shumë trajnime të NATO-s, të jeni pjesë e misioneve të ndryshme të NATO-s dhe të dëshmoni shkathtësitë dhe njohuritë e njejta si pjesëtarët e armatave aleate”, theksoi ministrja Shekerinska.

Kristina Ilievska

## Automjeti i blinduar „Terrex“ 8x8


**A**utomjeti i blinduar shumëdedikues amfib „Terrex 8x8“ u prodhuar në bashkëpunim midis Armatës së Singaporit, kompanisë irlandeze „Timoney Technology“, kompanisë nga Singapuri „Technology Kinetics“ dhe Agjencisë së Shkencës dhe Teknologjisë së Mbrojtjes. Automjeti është projektuar për të rritur efikasitetin luftarak të njësisve me ndihmën e një lidhjeje të madhe rrjeti që siguron rritje të ndërgjegjësimit për fushën e betejës, lëvizshmërinë në terren, fuqi të fortë zjarri dhe mbrojtje të mirë të armaturës. Blinduesi bazë e automjetit është bërë nga lidhjet e salduara të çelikut, të përshtatura për të pranuar module shtesë të blindimit të materialeve qeramike-përbërëse. Blinduesi bazë në anët mbron nga veprimi i predhave të blinduara me kalibër 7.62 mm, ndërsa pjesa e përparme mbron nga raketat e blinduara me kalibër 14.5 mm. Instalimi i blinduesit së kombinuar shtesë siguron mbrojtje rrethore kundër veprimit të predhave të blinduara me kalibër 14.5 mm, predhave nga predha artilerie, mjeteve shpërthyesë të improvizuara, falë dyshemesë së dyfishtë në formën e shkronjës „V“ dhe njëfarë mbrojtjeje nga minat tokësore. Në pjesën e përparme djathtas është një motor turbo dizel me 6 cilindra Caterpillar C9, me 450 kuaj fuqi, i kombinuar me transmisionin automatik Allison 4500SP Wide, i cili ka 6 shpejtësi për përpara dhe një shpejtësi për mbrapa. Për të zvogëluar reflektimin e IC, në anën e djathtë ka një mënyrë të veçantë të integruar për kullimin e gazrave të shkarkimit nga motori. Në anën e majtë është pozicioni i shoferit, dhe pas tij është komandanti i mjetit. Për nevojat e shoferit në kapakun e sipërm janë instaluar 3 periskopë për vrojtim, dhe për komandantin janë instaluar gjithsej 7 periskopë për vëzhgim, nga të cilët në kapakun e sipërm janë instaluar 3 periskopë, pas hapjes së tij plus 3 periskopë dhe në ana e majtë e hapjes së saj një tjetër periskop. Gjithsej 11 kamera janë të vendosura në të katër anët e mjetit, nga të cilat kamera termike për nevojat e drejtuesit është e vendosur në pjesën e përparme. Para dhe mbrapa janë të pajisura me drita IC për ngasje natën. Për nevojat e shoferit, para tij janë 3 ekrane (gjatë ngasjes me kapak të mbyllur) të cilët shfaqin imazhe nga kamerat, dhe në të majtë të tij është ekrani i modulit për ndërfaqe dixhitale me automjetin. Pozicioni i komandantit është i pajisur me një ekran me prekje nga sistemi i menaxhimit të fushëbetejës, plus një sistem të ekranit të shikimit për stacionin luftarak të telekomanduar. Për nevojat e komandantit të njësisë së uljes në departamentin e transportit, është instaluar edhe një ekran me prekje nga sistemi i menaxhimit të fushëbetejës. Pajisjet në automjet përfshijnë: sistem identifikimi „self-alien“, kondicioner,

sistem automatik të shuarjes së zjarrit, sistem mbrojtjeje ABHO, sistem navigimi si GPS, sistem zbulimi të të shtënave, etj. Kjo pajisje është e lidhur me sistemin e menaxhimit të fushëbetejës, i cili mundëson lidhjen e rrjetit dixhital me mjete të tjera të blinduara, tanke, artileri vetëlëvizëse, helikopterë luftarakë, avionë, etj. Në të njëjtën kohë, sistemi mund të krijojë një lidhje me ushtarët në terren nëse ata janë të pajisur me një sistem komunikimi luftarak të avancuar individual. Kjo mundëson komunikim të shpejtë dhe të sigurt, shkëmbim të të dhënave dixhitale për situatën taktike me komanda të paraqitura grafikisht që shfaqen në një ekran dixhital të hartës, gjë që kontribuon në rritjen e efikasitetit luftarak, krijimin e një pasqyre të qartë të fushëbetejës dhe marrjen e veprimeve të duhura. Pjesa qendrore është e pajisur me një stacion luftarak të telekomanduar ADDER (i njohur edhe si EOS R600), i cili është i pajisur me një granatëhedhës automatik të stabilizuar CIS 40, me një kalibër 40 mm (NATO), i cili ka një shpejtësi teorike të qitjes prej 350 deri në 500 granata në minutë dhe një rreze efikase prej 2200 m. „CIS 40“ ka një lartësi nga -10 ° në + 60 °, dhe me rrotullimin e kupolës ka një azimuth lëvizjeje prej 360 °. 60 granata janë përgatitur për veprim në stacionin luftarak. Në anën e djathtë të „CIS 40“ është instaluar mitralozi koaksial „M240“, kalibri 7.62 mm NATO, për të cilin ka 250 fishekë. Në stacionin luftarak të telekomanduar, në vend të granatës automatike mund të vendoset mitralozi i rëndë „CIS 50“ me kalibër 12.7 mm (NATO), i cili ka ushqim të dyfishtë me municion. Një kamerë me ngjyra CCD, një kamerë termike e natës dhe një matës rreze lazer me një rreze prej 5000 m janë instaluar për të monitoruar dhe synuar stacionin luftarak ADDER. Për mbrojtje automjeti është i pajisur me 6 hedhëse granata tymuese dhe në pjesën e pasme të sipërme të zonës së transportit, jashtë, mund të vendosen dy piedestale për mitralozë. Në pjesën e pasme është ndarja e transportit për 11 parashutistë, të rregulluar në 2 grupe përballë njëri-tjetrit. Në fund të automjetit ka një platformë uljeje me lëvizje hidraulike që lejon hyrjen / daljen e shpejtë, dhe rampa ka një derë ndihmëse më të vogël. Rrotat e automjetit kanë një suspension të pavarur, përkatësisht një kombinim i amortizimit hidropneumatik dhe McPherson, dhe kontrolli i automjetit arrihet përmes dy boshteve të përparme (4 rrota). Përveç transportuesit të blinduar të personelit, Terrex ka zhvilluar këto versione: mjet komandues, mjet inxhinierik, transportues mortajash, version mjekësor, version antitank me raketa të drejtuara, version zbulues dhe mjet shërbimi. U prodhuan gjithsej 454 automjete, nga të cilat 435 për Singaporin dhe 19 për Ganën.

Ivica Dameski



1. Kamera e prapme
2. Sistemi i dedektimit të qitjes (sipas drejtimit)
3. Kapakët e kulmit në pjesën e transportit
4. Pushkomitralozi
5. Stacioni me telekomandë ADDER
6. 3 periskopë për komandantin e automjetit
7. Kapaku i hapjes së komandantit të automjetit me 3 periskop të instaluar
8. Sedilja e komandantit
9. Sistem me menaxhimin e fushëbetejës
10. Displej për stacionin e administruar në distancë
11. Sedilja e shoferit
12. Sistemi digjital i navigacionit
13. Kapaku i hapjes së shoferit me 3 persikopë



- 14. 3 displejë që lidhen me kamerat e jashtme (për shoferin)
- 15. Mjeti anti rrufe
- 16. Blindues i cili mund të rezistojë gjatë veprimit të minave
- 17. Blindues, i përshtatshëm për pranimin e blinduesit tjetër modular pasiv për rritjen e nivelit të mbrojtjes
- 18. Konstruksioni i jashtëm në formë rrjeti për vendosjen e gjëseneve apo pajisjeve
- 19. Rrota të mëdhaja 395/80 R20 XZL me „run flat“ shtojca
- 20. Hekuri me sistem të vendosur për rregullimin automatik të presionit të rrotave
- 21. Hapësira për transportin e njësisë së desantit prej 11 ushtarëve
- 22. Sistemi i ABS frenave
- 23. Rrotulluese për lëvizjen në ujë (nga secila anë nga një)
- 24. Trau i madh për lëvizje në ujë me një derë më të vogël

#### KARAKTERISTIKAT TAKTIKO-TEKNIKE TË „TERREX“ 8X8

|                           |   |
|---------------------------|---|
| EKUIPAZHI                 | 2 anëtarë + 11 ushtarë                      |
| GJATËSIA                  | 7.78 m                                      |
| LARTËSIA                  | 2.46 m (deri në kulm)                       |
| GJERËSIA                  | 2.97 m                                      |
| PESHA                     | 24 ton                                      |
| NGARKESA                  | 7.2 ton                                     |
| MOTORI                    | Turbo dizel motor Caterpillar C9, co 450 ks |
| SHPEJTËSIA MAKSIMALE      | 105 km/h                                    |
| SHPEJTËSIA LUNDRUESE      | 10 km/h                                     |
| AUTONOMIA E LËVIZJES      | 300 km / 600 km (varësisht nga terreni)     |
| MBËSHTETËSJA E PËRPARME   | 60%   |
| MBËSHTETËSJA ANËSORE      | 40%   |
| NGJITJA ME PENGESË        | 60 cm                                       |
| TEJKALIM I PENGESËS UJORE | 1.8 m (pa përgatitje)                       |
| TEJKALIM PËRMES HENDEKUT  | 2 m   |



## Avioni zbulues „Lockheed YF-12”

**N**ë fund të viteve të 50'-ta, Forcat Ajrore të SHBA-së kërkuan zëvendësimin e interceptorit si pjesë e programit eksperimental të interceptorëve me rreze të gjatë. Zhvillimi i avionëve të ashtuquajtur “Black Birds” ishte një projekt i Luftës së Ftohtë. Ekipi i projektit drejtohej nga një zëvendës president i “Lockheed” me idetë e tij të avancuara dhe zhvillimore, i njëjti që kishte drejtuar më parë ekipin e zhvillimit të avionëve spiun “U-2”. „Lockheed YF-12” ishte një zëvendësues i mundshëm për përgjuesin e Forcave Ajrore të SHBA-së “F-106 Delta Dart”. “Lockheed YF-12” është një version me dy vende i aeroplanit zbulues të atëhershëm sekret “Lockheed A-12”, i operuar nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA). Ishte e pajisur me radar dhe mund të armatosej me raketa ajër-ajër. Ndryshe, ky avion është paraardhës i avionit zbulues “SR-71 Blackbird” për të cilin do të flasim në numrin e ardhshëm.

Avioni iu nënshtua vlerësimit të fluturimit nga Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara, por financimi i tij për përdorim operacional në atë kohë nuk ishte më

i disponueshëm, duke pasur parasysh prioritetet e tjera ushtarake (pjesërisht për shkak të kërkesave urgjente për Luftën e Vietnamit). Në fluturimin e tij të parë më 7 gusht të vitit 1963, ekzistenca e “YF-12” u zbulua publikisht nga Presidenti Lyndon B. Johnson në vitin 1964 në bazën e Forcave Ajrore Edwards (përndryshe baza nuk ishte përshtatur për këtë lloj avioni). Lëvizja kishte për qëllim të diferenconte flotën e udhëhequr nga CIA, e cila i ngjante

shumë prototipit “YF-12”. Në të njëjtin vit, Presidenti Johnson njoftoi se “Lockheed” po zhvillonte gjithashtu një “avion të avancuar strategjik zbulimi me rreze të gjatë për përdorim ushtarak, i aftë për inteligjencë në mbarë botën për operacione ushtarake”. Avioni me shenjë “SR-71” ishte një version i modifikuar i “YF-12”. Edhe pse më i rëndë se “YF-12”, avioni i ri spiun kishte rreze më të madhe dhe ishte i aftë për mbikëqyrje strategjike. Ky aeroplan spiun u miratua



nga forcat e armatosura, ndryshe nga "YF-12" që nuk u miratua. I ngarkuar nga kërkesa për aftësitë e tij pasardhëse, "YF-12" eksperimentale u mbajt në thelb deri në vitin 1969, me një ekip pilotësh të jashtëzakonshëm të vendosur në Qendrën Kërkimore të Fluturimeve të NASA-s.

Avioni "Lockheed YF-12" vendosi dhe mbajti rekorde botërore për shpejtësinë dhe lartësinë (më vonë u tejkalua nga "SR-71 Blackbird" i lidhur ngushtë) dhe ishte interceptori më i madh, më i rëndë dhe më i shpejtë i drejtuar në botë. Gjatë testeve të fluturimit nga Forcat Ajrore, si rezultate unike "YF-12A" vendosi një rekord shpejtësie prej 3,331 km/h dhe një lartësi rekord prej 24,462 metrash. I lyer me të zeze, avioni "YF-12" ishte bërë kryesisht nga aliazh titani, gjë që e lejoi atë të përballonte temperaturat e ndërtimit mbi 260° C. Avioni ishte i pajisur me sisteme kompjuterike që zgjidhën pothuajse plotësisht problemet e performancës. Testimi zbuloi vorbulla që pengonin ajrin e marrjes dhe një program i zhvilluar kompjuterik i inxhinierisë së fluturimit (i quajtur Central Airborne Performance Analyzer - CAPA) transmetoi të dhëna nga motori te pilotët me informacion për çdo defekt ose problem. Me shpejtësi kaq të mëdha, edhe ndryshimet e vogla në drejtim bënë që avioni të ndryshonte pozicionin me mijëra këmbë dhe shpesh kishte ndryshime të rënda në temperaturë dhe presion..

Qëllimi i forcave ajrore përfshinte kërkime në përdorimin e tij në një mjedis taktik për qëllime të paralajmërimit të hershëm ajror dhe kontrollit të avionëve supersonikë. Testi përfshiu gjithashtu NASA-n, e cila ishte përgjegjëse për çështje të tilla si performanca e hyrjes së motorit, ndërveprimi i ajrit në masë, zhurma kufitare, transferimi i nxehtësisë dhe mirëmbajtja e lartësisë me shpejtësi supersonike. Axhendat e Forcave Ajrore dhe NASA-s ndryshonin, me Forcën Ajrore të fokusuar në kërkimin luftarak dhe inxhinierët e NASA-s fillimisht u fokusuan në studimin e ngarkesave të fluturimit dhe ngrohjes strukturore. NASA studion efektet termike, strukturore dhe aerodinamike të fluturimit të qëndrueshëm në lartësi dhe shpejtësi të mëdha. Aftësia e "YF-12" për të mbajtur shpejtësi të larta lundrimi i lejoi NASA-s të zgjeronte aftësitë e saj kërkimore. Hulumtime të gjera janë kryer mbi aerodinamikën, shtytjen, kontrollet, strukturat, nënsistemet dhe fusha të tjera si fizika e atmosferës së sipërme, testet dhe matjet e zhurmës.



„Lockheed YF-12“, si një avion përgjues prototip u zhvillua dhe u prodhua nga linja ajrore amerikane "Lockheed Corporation" në fund të viteve të 50'-ta dhe fillim të viteve të 60'-ta.

Të dhënat e kërkimit të fluturimit "YF-12" u përforcuan nga një seri testesh në tunele aerodinamike, eksperimente laboratorike dhe analiza. Njohuritë dhe informacionet e krijuara u inkorporuan më vonë në projektimin e avionëve të tjerë supersonikë.

Të dhënat e fluturimit mbetën të klasifikuara shumë kohë pasi Presidenti Lyndon Johnson njoftoi avionin në 1964. Pas daljes në pension të tij nga Forcat Ajrore të SHBA-së, avioni shërbeu për ca kohë si një aeroplan kërkimor për NASA-n, e cila e përdori atë për të zhvilluar disa përmirësime të rëndësishme në kontrollin e avionëve të ardhshëm supersonikë. Në periudhën e viteve 1969 dhe 1979, dy prototipë të avionit „YF-12“ janë përdorur nga ana e Forcave Ajrore të NASA-s në Qendrën e Përbashkët Hulumtuese në kuadër të NASA Flight Research Center.

Ky avion ka një gjatësi prej 31 metrash, pesha pa ngarkesë është 27,700 kilogramë, ndërsa pesha maksimale e tij në ngritje është 63,500 kilogramë. Avioni "YF-12" përbëhej nga një ekuipazh prej dy personash - një pilot dhe një inxhinier fluturimi. Megjithatë ofroi sasi të mëdha të të dhënave kërkimore, programi i avionit "YF-12" u ndërpre kur axhenda kërkimore e NASA-s u zhvendos nga efektet e arritura me shpejtësinë e efekteve të efikasitetit. Gjatë jetës së tij nëntëvjeçare, programi kërkimor "YF-12" regjistroi 297 fluturime në programin e përbashkët NASA-Force Ajrore, me rreth 450 orë fluturimi. Ka mbetur vetëm edhe një avion „YF-12“, i cili është ekspozuar në Muzeun e Forcave Ajrore të SHBA-së (U.S. Air Force Museum, Wright-Patterson Air Force Base, Dayton, OH).

Dragan Pavlovski



## „Zulfiqar“ - Tanku bazik luftarak iranien

**G**enerali i brigadave i ushtrisë iraniane, Mir-Younes Masumzadeh, parashikoi zhvillimin e tankut „Zulfiqar“. Tanku besohet të jetë zhvilluar në bazë të tankeve M48, M60 dhe T-72. Prototipi i parë i „Zulfiqar I“ MBT, me pjesë indigjene, u projektua në vitin 1993 dhe u publikua për publikun në vitin 1994. Në vitin 1997, u zhvilluan gjashtë prototipa, testuan dhe u vendosën në terren. Po atë vit, presidenti iranien Hashemi Rafsanjani miratoi prodhimin masiv të tankeve në kompleksin industrial Shahid Kolah Duz. Janë prodhuar rreth 600 copë artilerie dhe 520 pjesë të ndryshme të tankeve, dhe 500 automjete të blinduara dhe tanke për prodhimin e tankeve „Zulfiqar“ u çmontuan. Kupola e tankut „Zulfiqar“ është projektuar në Iran si një kube me formë karakteristike dhe përfshin disa pjesë dhe sisteme të M60 dhe T-72 MBT. Si kupola ashtu edhe byka janë të salduara në çelik. Tanku ka një peshë luftarake prej rreth 52 tonë dhe ka një karikues automatik dhe mbrojtje të blinduar të përbërë. Përmirësimet e tankut „Zulfiqar III“ përfshijnë sistemin e përmirësuar të kontrollit të zjarrit, shasinë, armatimin, motorët dhe sistemet lazer.

### Llojet

„Zulfiqar I“ është ndërtuar me armaturë kompozite të përforcuar në harkun ballor. Përfshin një sistem të kompjuterizuar të kontrollit të zjarrit që mundëson qitjen

„Zulfiqar“ или „Zolfaqar“ është një tank luftarak bazik (MBT) i Ushtrisë Iraniane, i cili hyri në prodhim në vitin 1996. Emrin e ka marrë sipas shpatës së liderit të parë fetar, shpirtëror dhe politik të shiitëve, Hazret Ali Zulfiqar

plotësisht të stabilizuar. Një jastëk paralajmërues lazer është montuar në kube, ndërsa mbrojtja e tankeve mund të rritet me një paketë armaturë reaktive të bërë në vend.

Tanku luftarak bazik „Zulfiqar II“ është një version i përmirësuar i tankut „Zulfiqar I“. Përfshin motor të ri dhe më të fuqishëm dhe shasi të zgjeruar për të përmirësuar karikimin automatik.

„Zulfiqar II“ përdoret si stacion testimi dhe prototip i përkohshëm për variantin e radhës, „Zulfiqar III“. MBT „Zolfaqar III“ është versioni më i fundit dhe më i avancuar i familjes së tankeve „Zulfiqar“ dhe forcat tokësore të ushtrisë iraniane po kryejnë studime për të përmirësuar më tej aplikimet dhe teknologjinë e saj. Përmirësimet do të përfshijnë përmirësime në sistemin e kontrollit të zjarrit (navigimit), shasisë dhe armatimit, motorit dhe sistemit lazer, për të rritur aftësitë operacionale të tankut. Rrotat e pasme, ndihmëse dhe lëvizëse të variantit janë të mbuluara me një skaj të blinduar dhe kupolë (të përforcuar) të përforcuar.

Tanksi „Zulfiqar“ peshon 52 tonë dhe fuqizohet nga një motor naftë 12 cilindrash (12 cilindra Diesel AVDS-1790 diesel 1,100 Kw). Rezervuari mund të

lëvizë me një shpejtësi maksimale deri në 70 km / orë, shpejtësia mesatare e lëvizjes në tokë është deri në 40 km / orë. Gjatësia është 9.2 m, gjerësia 3.6 m ndërsa lartësia 2.5 m. Raporti i fuqisë dhe peshës së rezervuarit është 21.7 kf. Motori bashkohet me një transmetim automatik SPAT 1200 me gjashtë shpejtësi, i cili i siguron rezervuarit një shpejtësi maksimale prej 70 km/h (43 mph). „Zolfaqar III“ ka një sistem pezullimi me një shirit rrotullimi të ngjashëm me atë të tankeve kryesore të betejës M48 dhe M60. Gama e funksionimit të saj është 450 km. Sistemi i lëvizjes përbëhet nga shtatë rrota të dyfishta për anë të tipit të përdorur në M-60 / Sabalan, për shkak të bashkësisë së pjesëve, por prania e ndarjeve anësore nuk lejon të shihen detajet e modelit të pezullimit, të cilat janë sisteme me shufra përdredhjeje me amortizues të ardhur nga M60 por të përforcuar. Një palë rrota shtesë në pjesën e përparme shërben si tensionues / joaktiv-dembel. Ingranazhet e lëvizjes janë në pjesën e pasme, pikërisht pranë kutisë së marsheve. Vemjet janë gjithashtu të të njëjtit dizajn si M60, me një palë këpucë gome në çdo bashkues me kunjat të dyfishta. „Zulfiqar“ është amfib dhe mund

të përballojë deri në 1.60 m ujë, por nuk ka detaje nëse është i pajisur me zhytës. Shoferi ulet në të majtë, me vendkalimin dhe ka tre periskopë ditorë me një seksion vëzhgimi 180°.

## Armatimi

Tanksi „Zulfiqar I” është i armatosur me një top 125 mm, i adoptuar dhe marrë nën kontroll nga tanku sovjetik “T-72”. Varianti është i pajisur me sistemin silloven të kontrollit të zjarrit EFCS-3 nga "Safir-74" ose "Type 72Z". „Zulfiqar III” ka një top të fuqishëm “2A46” 125 mm me tub të lëmuar, dhe topi është i pajisur me tymin nxjerrës. Sistemi i siguron tankit teknologjinë për të shtënë në lëvizje. Një kapak paralajmërues lazer vendoset në kupolën e variantit të rrjedhës. Topi i avancuar mundësohet nga karikimi automatik. Armatimet dytësore të montuara në Zulfiqar përfshijnë një mitraloz koaksial 7.62 mm dhe një mitraloz 12.7 mm. Dy brigje me 4 granatahdhëse tymuese janë montuar në secilën anë të kupolës.

Një sektor i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Forcave të Armatosura të Republikës Islamike të Iranit, Grupi Industrial i Municioneve dhe Metalurgjisë Iraniane (AMIG) i Organizatës Industriale të Mbrojtjes (DIO), prodhon municione standarde për flotën e tankeve Zulfiqar. Tanket Zulfiqar III kanë gjithashtu sisteme të reja të kontrollit të zjarrit dhe një distanca lazer. „Zulfiqar” mund të hedhë game të gjerë të municionit si: HEP-T (High-Explosive Plastic Tracer), APFSDS-T (Armor Piercing, Fin Stabilized, Discarding Sabot - Tracer), HEAT-T (High-Explosive Anti-Tank - Tracer), APDS-T (Armor-Piercing Discarding Sabot-Tracer), APDS dhe HESH (High-Explosive Squash Head). Tanksi luftarak bazik drejtohet nga ekuipazhi i përbërë prej tre anëtarëve, duke përfshirë komandantin, shënjestruerin dhe shoferin.

## Armatimi

Blinduesi e trupit është bërë nga pllaka çeliku të salduara RHA, lustër tregon një pjerrësi të krahueshme me Chieftain dhe T-72. Dimensionet e bykut ndahen në gjashtë module të mëdha të blinduara që mund të zëvendësohen dhe përmirësohen lehtësisht. Ekspertët thonë se iranianët u frymëzuan si nga Mbrojtja Aktive Standarde e vitit 1980 T-72Z (ERA) dhe nga paketa e blinduar “Chieftain”. Çaktivizimi i një mbrojtjeje të tillë të blinduar kërkon raketa HEAT si dhe APFSDS. Detajet janë padyshim shumë konfidenciale. Megjithatë, asnjë tullë ekspozuese ERA nuk është parë ndonjëherë në rezervuarin “Zulfiqar”, kështu që vëzhgimi është vetëm pasiv.



Llojet e tankut „Zulfiqar I” dhe „Zulfiqar II” janë lloje operative në kuadër të armatës iraniane. Në maj të vitit 2010, armata iraniane e publikoi llojin e ri të avancuar të „Zulfiqar III”

| SPECIFIKIMET:                  |  |
|--------------------------------|--|
| GJATËSIA                       | 9,20 metra   |
| GJERËSIA                       | 3,6 metra  |
| LARTËSIA                       | 2,5 metra  |
| PESHA                          | 52 ton   |
| RAPORTI FUQI/PESHË             | 21.7hp/t   |
| EKUIPAZHI                      | 3 anëtarë  |
| ARMATIMI KRYESOR               | 2A46 125 mm smoothbore tank gun                                      |
| ARMATIMI DYTËSOR               | 12,7 mm co-axial machine gun, 7,62 mm machine gun                    |
| MOTORI                         | 12-cylinder Diesel AVDS-1790 diesel 1000 bhp (1.100 Kw) 17.85 hp/ton |
| AUTONOMIA E VARGUT             | 450 km (300 mi)  |
| SHPEJTËSIA MAKSIMALE NË RRUGË  | 70 km/h  |
| TEJKALIMI I PENGESËS           | deri 60%   |
| TEJKALIMI I PENGESËS ANËSORE   | 30%  |
| TEJKALIMI I PENGESËS VERTIKALE | 0,8 m  |
| TEJKALIMI I HENDEKUT           | 2,8 m  |
| TEJKALIMI I PENGESËS UJORE     | 1,6 m  |

Kupola “Zulfiqar III” është frymëzuar mirë nga “Abrams” dhe Koreja e Jugut “K1-88”. Pjesa e pasme e kupolës ka kosha të mëdhenj magazinimi, të ngjashëm me ato të “Abrams”. Për shkak se pamjet nga lart janë të rralla, nuk ka asnjë provë që panelet e shkarkimit janë të ngjashme me ato të tankeve “Leopard 2” dhe “Abrams” dhe ato janë vendosur mbi depon e municioneve në shportën e kupolës. Për mbrojtje aktive, kupola ka një jastëk paralajmërues lazer (që mbulon horizontin 360 gradë dhe lartësinë 60 gradë) dhe dy grupe kanalesh tymi standarde të tipit NATO në pjesën e përparme të kupolës.

Mirënjohja dhe dashuria e madhe ndaj vendit të tij, ndaj popullit të tij dhe ndaj aviacionit, Bllazhen e kanë sjellur deri në një nivel të degradimit ushtarak. Në fakt, gjatë viteve të pasluftës në Shkup ka vijuar një krizë e burimeve eneregjetike për ngrohjen e banesave. Bllazhe ka marrë disa informata se në rrehinën e aeroportit ka pasur disa çisterna me naftë, të lëna nga ana e ushtrisë gjermane gjatë luftës. Ai, me qëllim që të "ngrohë" popullin e tij, ka angazhuar ushtarë dhe robër nazistë, për të gjetur çisternat me naftë. Nafta është gjetur dhe i është ndarë popullit, por pavarësisht humanitetit të dëshmuar, për shkak të angazhimit të robërve nazistë, atij i është tërhequr vëretja nga ana e udhëheqësisë ushtarake. Pas kësaj, Troshanovski është demobilizuar dhe e ka lënë karrierën profesionale në armatën e atëhershme popullore. Pas demobilizimit ai punësohet dhe njëkohësisht emërohet në një vend udhëheqës në fabrikën e çimentos në Han të Elezit. Aty ai e ka gjetur edhe Ljubomir Tavçevin, njërin ndër themeluesit e aviacionit maqedonas, që nga periudha mes dy luftërave botërore. Gjatë kontakteve me të, Bllazhe ka filluar me përfshirjen e tij të drejtëpërdrejtë dhe me mbështetjen për zhvillimin e aeroklubeve maqedonase. Para fundit të viteve të dyzeta të shekullit të kaluar, si një kuadër i edukuar dhe profesionist, Bllazhe Troshanovski emërohet në detyrë udhëheqëse në Ministrinë e Industrisë dhe Ndërtimtarisë të RS të Maqedonisë, ku edhe e përfundon karrierën e tij profesionale. Kjo ka qenë edhe fundi i karrierës së tij profesionale, por jo edhe fundi i dashurisë dhe aktiviteteve në kuadër të aviacionit maqedonas, ku i kishte drejtuar të gjitha aktivitetet e tij. Ai gjithnjë ka qenë në udhëheqësinë e Lidhjes Ajrore të Maqedonisë, si dhe Qendrës Ajrore Republikane. Pa ndërprerë, me një entuziazëm të paparë, ai vazhdimisht ka vizituar aeroklubet maqedonase. Si një strateg ushtarak me përvojë, ai ka dhënë kontribut edhe në përzgjedhjen e kuadrove të pilotëve për kandidatë për shkollën e pilotëve rezervë pranë forcave të atëhershme ajrore jugosllave. Bllazhe Troshanovski me plot meritë zë vend në kuadër të aviacionit maqedonas, me dashurinë, entuziazmin dhe aktivitetin në fushën e aviacionit, si dhe me ndjenjën për përkatësinë kombëtare dhe shtetërore duke fituar shumë medalje, mirënjohje, diploma, si dhe para se gjithash duke lënë gjurmë të pashlyera për të dhe për veprat e tij.

Gjorgji Çaçkirov

## Rezultate për respekt në kuadër të trajnimit

Edhe përkundër kushteve specifike të punës dhe jetës së shoqërisë në tërësi, duke i pasur parasysh kushtet dhe situatën aktuale me pandeminë COVID-19, në trajnimin e oficerëve dhe nënoficerëve rezervë në vitin 2021 janë arritur rezultate për respekt, sidomos nëpër njësitë komunale organizative (NJKO) të OORRMV-së. Ky vlerësim pozitiv është edhe më i rëndësishëm në qoftë se kemi parasysh faktin se kjo ndodh në bazë vullnetare, ku faktet flasin edhe për ndjenjën e vërtetë të përgjegjësisë dhe motivimit, kur kemi të bëjmë me përfitim e njohurive dhe shkathtësive të reja ushtarake, në funksion të fuqizimit të sistemit të mbrojtjes. Si dëshmi për këtë vlerësim do të përmendim edhe numra konkret që janë publikuar në raportin për vitin 2021.

Në marshet edukativo-kondicionuese kanë qenë të përfshirë 210 oficerë dhe nënoficerë rezervë (janë realizuar gjithsej 7 marshe të këtilla në NJKO e Tetovës, Berovës, Pehçevës, Strumicës dhe Demir Hisarit, 4 nga të cilat vetëm në Tetovë gjë që meriton në veçanti të theksohet kur kemi të bëjmë për këtë NJKO). Në kuadër të aktiviteteve për respektimin e traditave liridashëse në 10 NJKO: (në Shkup, Kumanovë, Vinicë, Dellceve, Makedonska Kamenicë, Tetovë, Berovë, Pehçevë, Manastir, Prilep dhe Shtip), ishin të angazhuar 550 nënoficerë dhe oficerë rezervë. Në aktivitetet ndërkombëtare kanë marrë pjesë 15 oficerë rezervë. Vlen të theksohet se në mbledhjen verore të mbajtur "online" të Komitetit të Konfederatës Ndëreale të

Oficerëve Rezervë (CIOMR), OORRMV, njëzëri fitoi statusin e anëtares ndjekëse, ndërsa në kongresin e ardhshëm, ky status do të ngritet në një nivel më të lartë – si anëtare e barabartë e CIOMR. Sipas rikapitularit, të aktiviteteve të zhvilluara në përgjithësi, me programin e OORRMV-së për vitin 2021, kanë marrë pjesë gjithsej 775 pjesëtarë të organizatës.



## Avancimi i shkathtësive ushtarake

Edukimi dhe trajnimi i nënoficerëve dhe oficerëve rezervë në vitin 2022 do të jetë njëra ndër detyrat më kryesore të OORRMV-së, ndërsa e gjithë kjo do të organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, SHP të ARMV-së dhe Komandën e Forcave Rezerve. Janë planifikuar shumë përmbajtje aktuale sipas standardeve të NATO-s dhe sipas nevojave të sistemit të mbrojtjes, të cilat do të kontribuojnë ndaj thellimit të mëtejshëm dhe zgjerimit të njohurive dhe avancimit të shkathtësive të anëtarëve të OORRMV-së. Do të përmendim disa nga më të rëndësishmet: në 10 njësi komunale organizative do të organizohen tribuna me tema aktuale në përpilimin e të cilave do të mund të marrin pjesëmarrës përpos oficerët rezervë, edhe përfaqësues të subjekteve të tjera të sferës së mbrojtjes dhe sigurisë ("Roli i fuqive të mëdha në gjeopolitikën e Ballkanit"; "Kërcënimet e sigurisë kibernetike në rajon dhe mundësitë për mbrojtje në kuadër të sistemit të sigurisë"; "Bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e sigurisë ndërmjet vendeve të rajonit"). Në

pjesën praktike të trajnimit, në vendqitjen "Dollno Orizari" do të mbahet gara shtetërore në qitje me revole 7,62 mm, garë në të cilën do të marrin pjesë 110 oficerë dhe nënoficerë nga NJKO e OORRMV-së. Marshi tradicional edukativo-kondicionues me rastin e Ditës së OORRMV-së do të realizohet në rajonin e Ohrit (f. Leskoec-f. Skrebatno), në distancë prej 10 km me pjesëmarrjen e 100 oficerë dhe nënoficerë rezervë nga pjesa jugperëndimore e vendit. Në rajonin lindor do të organizohet marsh rajonal në relacion: f. Smollarë- Ujëvarat e Smollarit, f. Mokrievë, në distancë prej 8 km me pjesëmarrjen e



100 oficerëve dhe nënoficerëve rezervë nga OORRMV. Në Kërçovë në vendqitjen "Osoj" si dhe në Veles në vendqitjen "Dollno Orizari" do të organizohen qitje me AP 7,62 mm në numër rendor 1, me pjesëmarrjen e gjithsej 160 oficerë dhe nënoficerë rezervë. Qitjet kanë të bëjnë me avancimin e shkathtësive ushtarake në përdorimin e armëve të këmbësorisë. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, përfaqësues të OORRMV-së do të marrin pjesë në një kongres të CIOR, në një mbledhje të nismës GAMINGER, si dhe në disa aktivitete tjera të planifikuara në programet e këtyre dy asociacioneve ndërkombëtare. Gjithashtu, 10 anëtarë të OORRMV-së do të jenë pjesë e Akademisë Gjuhësore që do të mbahet në Greqi, në Halkida, në ishullin Evia, ndërsa do të intenzifikohet edhe bashkëpunimi bilateral me asociacionet e oficerëve rezervë të: Serbisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Shqipërisë. Në aktivitetet e planifikuara për vitin 2020, gjithsej do të marrin pjesë 1.775 nënoficerë dhe oficerë rezervë.

## Intenzifikim i aktiviteteve për shënimin e 70 vjetorit të OORRMV-së

Më 9 dhjetor, u mbajt mbledhje konstituive e Sekretariatit të Këshillit për Shënimin e 70 vjetorit të formimit të OORRMV-së, me të cilin udhëhoqi kapetani rezervë, Zoran Kirovski, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të OORRMV-së. Në këtë mbledhje u miratua propozimi i programit për shënimin e jubileut. Gjithashtu, u dhanë rekomandime për përpilimin e programave të komisioneve si grupe të punës të këshillit. Duke e pasur parasysh rëndësinë e jubileut, i njëjti do të organizohet nën patronazhin e presidentit të vendit, njëherit edhe komandant suprem i forcave të armatosura, Stevo Pendarovskit, ndërsa shënimi i jubileut, tashmë është pjesë



e kalendarit për shënimin e ngjarjeve dhe personaliteteve në nivel shtetëror. Akademia solemne është paraparë të zhvillohet më 29 prill të vitit 2022 në Shkup, me pjesëmarrjen e 400 aktivistëve të OORRMV-së dhe me mysafirë nga organizatat me të cilat bashkëpunon OORRMV-ja si organizatat nga: Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Shqipëria. Gjatë muajit mars dhe muajit prill, mbledhje solemne do të mbajnë njësitë komunale organizative, ku përpos referatit të rastit, anëtarëve më të dalluar do t'ju ndahen mirënjohje të rastit (medalje, pllaketa shenja jubilarë dhe lëvdata). Gjithashtu, vijon edhe përgatitja e monografisë në të cilën, përmes tekstit dhe fotografive do të prezantohet zhvillimi i OORRMV-së, që nga formimi në vitin 1952 e deri në vitin 2022. Është vlerësuar se përmbajtjet dhe aktivitetet tjera që janë në kuadër të programit e punës për vitin 2022, do të intenzifikohen dhe do të jenë në shenjë të shënitit të 70 vjetorit të themelimit. Gjatë vitit jubilar, organet dhe trupat e OORRMV-

së do të angazhohen gjithashtu edhe për shumë çështje tjera, që kanë të bëjnë me funksionimin e rregullt të organizatës mes të cilave janë edhe: precizimi i statutit të OORRMV-së në ligjin për mbrojtje; rishikimi i mundësisë për avancimin e inordiner të oficerëve rezervë në gradë më të lartë; inicimin e një propozimi deri te Ministria e Mbrojtjes për shëndrrimin e konceptit të forcave rezerve në një vendim konkret për një formacion ushtarak (si brigadë e forcave rezerve); bashkërendimin e metodave të punës me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira. Në kuadër të sistemit aktual të trajnimit dhe profesionalizimit të kuadrave për nevojat e mbrojtjes, avancimin e statusit të OORRMV-së, ku gjithnjë e më tepër nevojitet të shprehet si një pjesë integruese i sistemit të këtyre të përgatitjes, trajnimit dhe profesionalizimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



## Jeta dhe vepra e Mirçe Acevit përmes përmendoreve dhe pllakave përkujtimore, përmes muzikës dhe filatelisë

**P**llaka përkujtimore e Mirçe Acevit në Shtegun e Heronjëve Kombëtarë, në oborrin e "Kombinatit të Duhanit", ka gjithashtu pllakë përkujtimore edhe në kazermën "Mirçe Acev", në gjimnazin e Prilepit, ku gjithashtu ka edhe një pllakë tjetër përkujtimore në ndër të tij. Emri i tij është shkruar gjithashtu edhe në pllakat e mermerit të "Mogilla" e të pamposhturve në Parkun e Revolucionit në Prilep. Pllakë përkujtomore ka edhe para shtëpisë në Prilep ku ka jetuar familja Acev. Ekzistojnë edhe disa pllaka tjera përkujtimore në qytetin e Prilepit, por edhe në vende të tjera.

Në përshkrimin më të thellë për jetën dhe veprën e Mirçe Acevit, historian Rubinço Bellçevski mes tjerash përmend se më 1 shkurt të vitit 1945, ka filluar me punë gjimnazi "Mirçe Acev" në Prilep, i cili mban emrin e herojit dhe ka qenë i vendosur në hapësirat e ish shkollës fillore në qendër të qytetit, ku më 1949, të ndërtohet edhe objekti ri i gjimnazit në të cilin këtyre ditëve përfundon restaurimi dhe rinovimi i tërësishëm i pjesës së brendshme dhe të jashtme të godinës.

Dhjetra kilometra larg Prilepit, më parë ka ekzistuar një vend i banuar i quajtur Mirçe Acev, vend i cili tashmë fatkeqësisht është fshirë nga harta e vendeve të banuara në shtet dhe përfaqëson vetëm një pjesë të historisë. Ish Shtëpia e Pionerëve në Prilep, më vonë Qendra e Krijimtarisë për Fëmijë, gjithashtu e ka mbajtur emrin e heroit,

Jeta dhe vepra e heroit të kombit Mirçe Acevit është e pranishme në tërë vendin përmes përmendoreve, pllakave përkujtimore, shoqëritë kulturoro-artistike, përmes muzikës dhe më e rëndësishmja, është i pranishëm edhe në kazermën e Prilepit, si pjesë e forcave të armatosura dhe të sigurisë, gjegjësisht si pjesë e Armatës, sepse kjo kazermë mban emrin e këtij heroit dhe në këtë mënyrë vazhdohet tradita e njëjësive ushtarake të LNÇ-së. Ky vendim është sjellur për arsye se aradha e parë partizane në Maqedoni e formuar në vitin 1944, mbante emrin e Mirçe Acevit

ndërsa në qytetin nën Kullat e Markos, ekziston rrugë dhe lagje që mban emrin e tij. Gjatë ekzistimit të ish shtetit, ka pasur shoqatë bujqësore që e ka mbajtur emrin "Mirçe Acev", shoqatë e cila më vonë është riemërtuar në "ZIG Prilep".

Në shtet, ekzistojnë shkolla që e mbajnë emrin e tij, në rajonin e Shkupit, Manastirit, Kërçovës, por pasi që Mirçe Acevi që nga ditët e fëmijërisë ka pasur simpati për folklorin, në Prilep ekziston edhe SHKA "Mirçe Acev". Një shoqëri e tillë ekziston edhe në vendin e quajtur Topollçani. Në vitin 1949, në Shkup është forumuar edhe SHKA "Mirçe Acev", që është anëtare bashkangjitime e USHKM.

Mirçe Acevi është "prezent" edhe në filateli. Në vitin 1951, siç e përmend edhe historian Bellçevski, me rastin e 10 vjetorit të 11 Tetorit 1941, Ditës së Kryengritjes Popullore, posta e atëhershme ka bërë publike pullën postale me fytyrën e Mirçe Acevit. Mirçja është edhe pjesë e muzikës. Kënga "Jasno mi sonce

izgreva" autor i së cilës është Aleksandar Taleski-Çerçillo, është shkruar për nder të heroit dhe për familjen e tij. Më vonë, këngë për Mirçe Acevin, së bashku me Strasho Pinçurin i është kushtuar nga ana e themeluesit të Radio Prilepit, spikerit Goga Zafirovskit.

Përveç kësaj, për jetën dhe veprën e Mirçe Acevit janë shkruar shumë përmbledhje dhe vepra, që do të thotë se heroit përmendet gjithnjë dhe nuk harrohet. Mirçe Acevi është personalitet i palodhur prej krijuesi me shpirt të madh. Vepra e tij edhe më tutje duhet të shërbejë si udhërrëfyes për gjeneratat e tashme, por edhe për të ato që do të vijnë pas, për ata të cilët duhet t'a ndjekin dhe t'a respektojnë, ndërsa disa prej tyre janë gjithësesi edhe pjesëtarët e Batalionit Artilerik të kazermës "Mirçe Acev" dhe nxënësit e gjimnazit "Mirçe Acev", të cilët gjatë muajit janar do t'a shënojnë përvjetorin e vdekjes së tij.

Karolina Micevska



## Karriera, bashkësia dhe qëllimi – tre gjërat që i dëshiron çdo i punësuar

**N**ëse më herët organizatat ndërtonin apo zhvillonin kultura të tëra rreth vetëm njërit prej këtyre motivatorëve, sipas hulumtimit më të ri të Facebook, më shumë se një e katërta e personave të anketuar me status në marrëdhënie pune, këto tre motivatorë i vlerësojnë si shumë relevante, ndërsa 90% tjetër, deklarojnë se të paktën dy nga tre motivatorët janë më relevante. Në mënyrë analogjike, edhe përkundër stereotipeve, del se “mileniumët” i kanë vlerat e njejta themelore si të gjithë ne, përdërisa inxhinierët kujdesen shumë më tepër për lidhjen ndërmjet njerëzve. Në fakt, ngajshmëri hasen edhe përmes lokacioneve gjeografike, ndërsa rezultati ka të bëjë me faktin se të gjithë ne shpresojmë se do të gjejmë përgjigjen e pyetjeve të cilat fillojnë me çfarë, kush dhe pse. Në përgjithësi, secila bisedë për vlerat e punës përmban edhe pjesë në të cilën përmendet edhe teoria më e njohur e psikologut të njohur Abraham Masllou, dhe piramida e nevojave.

Çfarë është ajo që i motivon njerëzit në punë? Facebook vendosi të përgjigjet në këtë pyetje përmes një analize të përgjigjeve që dhanë të anketuarit për fuqinë punëtore, që e realizojnë dy herë në vit. Analiza në fjalë nxori në pah tre motivatorë kryesor: karierrën, bashkësinë dhe qëllimin

Idea e tij e madhe nuk ka të bëjë vetëm me klerarkinë e nevojave, por e njejta potencon se sa të plotësohen nevojat tona bazike fiziologjike dhe ato të sigurisë, të gjithë ne, së pari kërkojmë dashuri dhe përkatësi, e më tej vetërespekt dhe prestigj, dhe në fund vetëaktualizim. Por, kjo piramidë është ndërtuar para më se gjysëm shekulli,

ndërsa psikologët tashmë konkludojnë se kësaj piramide i nevojitet rifreskim apo të a.q riparim. Megjithatë, nëse i shqyrtojmë dëshmitë nga disa dekada të kaluara të marra nga shkencat shoqërore, vështirë se do të debatohet për pikën fillestare të Masllouit. Në fakt, nëse nevojat tona elementare nuk janë të kënaqshme, nuk do t’u kemi lehtë që të fokusohemi në ndonjë gjë tjetër. Ose, nga ana tjetër, në qoftë se puna jonë nuk është e paguar sa duhet, ndërsa ne nuk bëjmë gjumë me netë të tëra duke menduar se si do të mbijetojmë, me siguri se nuk do të shpenzojmë shumë kohë për t’u marrë me vetëaktualizimin. Por, Masllou e ka ndërtuar këtë piramidë në fillim të zhvillimit të lëvizjes për marrëdhëniet ndërnjerëzore, kur shumë vende të punës në kuadër të ekonomisë prodhuese nuk kujdesen për nevojat bazike fiziologjike dhe atyre të sigurisë. Ndërsa sot, shumë kompani punojnë në bazë të ekonomisë së diturisë dhe shërbimeve. Me këtë rast, ato nuk i plotësojnë vetëm nevojat elementare, por synojnë të plotësojnë


secilën nevojë, duke siguruar gjera të dobishme, si për shembull shujta, vakte dhe salla sportive për të punësuarit e tyre, ndërsa të njejtat garojnë edhe të shëndrohen në vende më të përshtatshme apo më të dëshiruara të punës (për shembull, kompanitë që gjatë periudhës së viteve 1984 deri në vitin 2011 kanë pasur sukses në këtë plan, kanë kthyer aksionet e tyre për 2,3% deri në 3,8% në nivel vjetor). Në këto rrethana, mbijetesa nuk vihet në pikëpyetje. Për këtë shkak, parashtrohet

se ajo bën diçka të mirë në botë, dhe e njejta na bën krenarë. Këto tre motivatorë e përbëjnë atë që e quajmë marrëveshje psikologjike – pritjet e pashkruara dhe obligimet në mes të punësuarve dhe punëdhënësve. Kur do të përmbushet marrëveshja, njerëzit japin gjithçka nga vetja e tyre në vendin e punës. Por, kur ndodh e kundërta, njerëzit janë më pak të kënaqur dhe më pak të përqëndruar, edhe kontributi i tyre në organizatë/ institucion është në një nivel më të ulët,

nga të tjerët, analiza e bërë vërteton se ndër grupmoshat madhore prioritetet janë jashtëzakonisht të ngjajshme. Dhe e kundërta e besimit se “mileniumët” më tepër merren me domethënien dhe qëllimin, del se njerëzit e rinj gjithnjë e më pak kujdesen për qëllimin, e shumë më tepër për karrierën, përderisa te më të vjetrit, kjo nuk është ashtu. Gjegjesisht personat e moshës deri në 55 vjet apo më shumë se aq, janë grupi i vetëm në Facebook e cila gjithnjë e më shumë kujdeset për qëllimin se sa për bashkësinë apo për karrierën. Këtë e vërtetojnë edhe faktet se kah mesi i jetës së tyre, njerëzit shumë më tepër kujdesen për kontributin në shoqëri, ndërsa më pak janë të përqëndruar në avancimin e karrierës individuale. Në përgjithësi, dallimet ndërmjet grupeve madhore nga hulumtimi, janë të vogla. Dhe kjo nuk është ashtu vetëm te hulumtimet të realizuara nëpërmjet Facebook, por edhe nga hulumtimet representative nacionale të amerikanëve nëpër gjenerata apo të a.q Millennials, Baby Boomers dhe Gen Xers, të cilat i ndajnë vlerat e njejta bazike dhe të cilat kanë tendencë të radhitin në rradhitjen e njejtë sipas rëndësisë. Gjithashtu, nuk janë vërejtur dallime të mëdha sipas niveleve apo sipas kontrolleve të performacave, apo me fjalë të tjera, njerëzit i vlerësojnë këto tre motivatorë, pa marrë parasysh se a i tejkalojnë të njejtat, i plotësojnë apo nuk i plotësojnë pritshmëritë e tyre. Por, në rast se kontrollohen lokacionet e kancelarive të cilat kanë qenë pjesë e hulumtimit, bëhet e qartë se karriera, bashkësia dhe qëllimi janë të vlerësuara në tërë botën. „Të bëhet e qartë se çfarë në të vërtetë kërkohet është një arritje e jashtëzakonshme psikologjike“, thotë Masllou. Njerëzit janë shumë të qartë për atë se çfarë është ajo që ata dëshirojnë, ndërsa në esencë ata i dëshirojnë punën e njejta. Gjegjesisht kur bëhet fjalë për një punë ideale, shumica prej nesh kërkojnë karrierë, bashkësi dhe qëllim. Këta janë motivatorë të rëndësishëm në kuadër të punës, pa marrë parasysh se a kemi 20 apo 60 vjet, se a punojmë si inxhinierë, ose kemi punë me shitje, a punojmë në San Paolo, në Singapor apo në Detroit.



pyetja, nëse Masllou e dizajnon piramidën e tij në kohën e sotme për të sqaruar se çfarë i motivon njerëzit në punë, përpos nevojave bazike, si do të dukej ajo piramidë. Kjo është çështja që Llori Goler, Xhejnell Gejll, Brin Harrington, Adam Grant të lidhur në aspektin profesional me Facebook, në bashkëpunim me ekipin e tyre të analizës nga Facebook, përpiqen të përgjigjen. Në fakt, Facebook e hulumton fuqinë e tyre punëtore dy herë në vit, duke pyetur se çfarë është ajo që të punësuarit e vlerësojnë më tepër. Sipas analizës së qindar mijëra përgjigjeve, Llori Xhenell, Brin dhe Adam me ekipin e tyre kanë identifikuar tre motivatorë të mëdhenj: karrierë, bashkësi dhe qëllim. Karriera është puna: duhet të kemi një punë e cila siguron autonomi, e cila na mundëson ti përdorim anët tona të fuqishme, duke e promovuar mësimin dhe zhvillimin tonë. Kjo gjë është në zemrën e motivimit të brendshëm. Bashkësia për njerëzit: ndjenja e respektit, kujdesit dhe mirënjohjes nga ana e të tjerëve. Kjo e inkurajon ndjenjën tonë për lidhjen dhe përkatësinë. Qëllimi ka të bëjë me arritjen: ndjenja se jemi me ndikim, gjegjesisht impakt, bashkërendohemi me misionin e organizatës dhe besojmë



gjegjesisht të punësuarit nuk e kryejnë punën si duhet. Përgjigjet e pyetjeve se disa motivatorë të caktuar janë më të rëndësishëm se disa motivatorë tjerë, mund të klasifikohen në kategori. Në qoftë se nisemi nga kategoria e moshës, do të vërejmë se edhe pse flitet se “mileniumët” janë shumë të ndryshëm

Mr. Biljana Popovska  
 (adaptuar nga Llori Goler, Janelle Gale, Brynn Harrington, Adam Grant/ [https://hbr.org/2018/02/people-want-3-things-from-work-but-most-companies-are-built-around-only-one?utm\\_medium=social&utm\\_campaign=hbr&utm\\_source=facebook&tpcc=orgsocial\\_edit&fbclid=IéAR0Hvt9fJhKG3tin1GaUNpyNDe0Gwjycjo-K\\_nXPkXimqx19V9t-GlgUnyo](https://hbr.org/2018/02/people-want-3-things-from-work-but-most-companies-are-built-around-only-one?utm_medium=social&utm_campaign=hbr&utm_source=facebook&tpcc=orgsocial_edit&fbclid=IéAR0Hvt9fJhKG3tin1GaUNpyNDe0Gwjycjo-K_nXPkXimqx19V9t-GlgUnyo))



## Kunijoshi ukio-e i fundit

**U**tagawa Kuniyoshi është një nga mjeshtrat e fundit të mëdhenj të UKIO-E japoneze, stilit të printimit dhe pikturës së drurit. Gama e temave të mbuluara nga Kuniyoshi përfshin shumë zhanre: peizazhe, gra të bukura, aktorë kabuki, mace dhe kafshë mitike. Ai është i njohur për paraqitjen e betejave të heronjve legjendar samurai. Vepra e tij artistike



përfshinte aspekte të përfaqësimit perëndimor në pikturën e peizazhit dhe karikaturën.

Kuniyoshi lindi më 1 janar të vitit 1798. Babai i tij, Yanagia Kichiemon, ishte një ngjyruer mëndafshi. Emri i lindjes së Kuniyoshi është Yoshisaburi. Ai ndoshta e ndihmoi babanë e tij të punonte si dizajner model, dhe sipas disave, kjo përvojë pati një ndikim të thellë në paletën e tij të gjerë dhe të pasur të ngjyrave. Besohet se qysh në moshë të re ai ishte i impresionuar nga gjurmët e luftëtarit wokio-e dhe imazhet e mjeshtrit të atëhershëm të njohur. Yoshisaburi dëshmon talentin e tij në vizatim në moshën 12-vjeçare, duke tërhequr shpejt vëmendjen e mjeshtrit të famshëm të stilit ukio-e (Utagawa Toyokuni). Ai u pranua zyrtarisht në studion e Toyokuni në vitin 1811 dhe u bë një nga studentët e tij kryesorë. Atje ai punoi si çirak deri në vitin 1814 dhe gjatë asaj kohe ai përsosi njohuritë e tij, por formoi edhe stilin e tij të njohur. Në atë kohë ai mori emrin Kuniyoshi dhe filloi si një artist i pavarur. Gjatë këtij viti ai krijoi veprën e tij të parë të botuar, Ilustrimet e Kubanit Gakan Gobuji Chashingura, një parodi e historisë origjinale të Chashingura. Midis viteve 1815 dhe 1817 ai krijoi një numër ilustrime librash për Yomihon, Cokeibon, Gokan dhe

Hanashibon dhe shtypi printimet e tij me ngjyra të aktorëve dhe luftëtarëve Kabuki. Pavarësisht nga një debutim premtues, i riu Kuniyoshi nuk arriti të prodhonte shumë vepra midis viteve 1818 dhe 1827, ndoshta për shkak të mungesës së porosive nga botuesit, por edhe për shkak të konkurrencës nga artistë të tjerë të shkollës Utagawa. Gjatë kësaj periudhe ai bëri piktura të grave të bukura (beijing-ga) dhe eksperimentoi me modele të mëdha tekstile dhe efekte hije-drite që gjenden në artin perëndimor, megjithëse këto përpjekje treguan më shumë imitim sesa një kuptim të vërtetë të këtyre parimeve. Situata ekonomike në një moment bëhet e dëshpëruar, ndaj detyrohet të shesë tatami të përdorura. Një takim i rastësishëm me shoqen e tij të suksesshme të klasës Kunisada, për të cilën ndoshta ndjeu pak xheloz sepse besonte në talentin e tij superior artistik, e bëri atë të dyfishonte përpjekjet.

Ky rivalitet nuk krijoi asnjë ndjenjë të keqe mes dy artistëve të cilët më pas bashkëpunuan në një sërë serialesh. Gjatë viteve 1820, Kuniyoshi krijoi një sërë triptikësh me skena heroike që tregojnë shenjat e para të stilit individual. Në 1827 ai mori porosinë e tij të parë të madhe për serialin "Njëqind e tetë heronj të Suikodenit popullor", bazuar në tregimin



tepër popullor kinez Shuihu Wyanan. Në këtë seri, Kuniyoshi prezanton heronj individualë në fletë të vetme, duke vizatuar tatuazhe mbi heronjtë e tij, një risi që ndikoi shpejt në periudhën edo. Seriali Suikoden u bë jashtëzakonisht i popullarizuar gjatë kësaj periudhe dhe kërkesa për printimet e luftëtarëve Kuniyoshi u rrit, duke fituar hyrjen në

qarqet e elitës.

Në periudhën që pasoi, ai vazhdoi të krijonte printime të luftëtarëve, duke tërhequr shumë nga temat e tij nga historitë e luftës si Përralla e Ndjekjes dhe Ngritja dhe Rënia e Minamoto dhe Taira (Genpei Seisui). Gjurmët e tij të luftëtarëve janë karakteristike dhe unike në atë që ai shton një përshkrim shtesë imagjativ të ëndrrave, shfaqjeve fantazmë, shenjave dhe bëmave mbinjerëzore përshkrimeve të të famshëmve legjendar. Ky objekt është ngulitur në veprat e tij "Fantazma e Tyra pa Tomomori" në Gjirin e Daimotsu dhe në triptikun "Ura Gayo" e vitit 1839, ku ai arrin të ngjall tek shikuesi një ndjenjë e intensitetit të veprimit në përshkrimin e betejës. midis Yoshitsune dhe Benkei. Këto stile të reja me tematikë zgjuan interesin e publikut për të tmerrshmen, emocionuesen dhe të çuditshmen, karakteristike e asaj kohe.

Reformat e Tenpes nga viti 1841 deri në 1843 synonin të lehtësonin krizën ekonomike duke kontrolluar shfaqjen publike të luksit dhe pasurisë, dhe ilustrimi i kurtezanëve dhe aktorëve në Ukiya u ndalua zyrtarisht në atë kohë. Kjo mund të ketë pasur njëfarë ndikimi në punën e Kuniyoshi, kështu që në atë kohë ai shtypte karikaturat ose komike (giga), të cilat i përdorte për të maskuar aktorët dhe kurtizanët e vërtetë. Shumë prej tyre kritikojnë në mënyrë simbolike dhe humoristike shogunatin, siç është vepra e vitit 1843, e cila tregon Minamoto No Jorimitsu duke fjetur, të përhumbur nga Spider-Man dhe demonët e tij, një vepër që është bërë shumë e njohur për publikun e pakënaqur politikisht. Kufizimet e krijuara nga qeveria e atëhershme u bënë një lloj sfide artistike që, në



fakt, inkurajoi shkathësinë krijuese të Kuniyoshi, duke e detyruar atë të gjente mënyra për të fshehur alegorikisht kritikën ndaj manjatis.

Në fund të viteve 1840, Kuniyoshi filloi të ilustrojë përsëri printimet e aktorëve, këtë herë duke shmangur censurën në një mënyrë që përdorte në mënyrë krijuese skenarët elementare për fëmijë, të shkruara në mënyrë të ngathët në kana nën fytyrat e aktorëve. Duke treguar dashurinë e tij për macet, Kuniyoshi krijon vepra në të cilat zëvendëson njerëzit me mace në kabuki dhe printime satirike. Në 1856, Kuniyoshi u sëmur nga paraliza, e cila i shkaktoi vështirësi të mëdha në lëvizjen e gjymtyrëve. Në 1861, Kuniyoshi ishte dëshmitar i hapjes së qytetit port të Yokohama për të huajt, kështu që në 1861 ai krijoi dy vepra që përshkruanin popujt perëndimorë të qytetit. Po atë vit më 1861, Kuniyoshi vdiq në moshën 63 vjeçare në shtëpinë e tij .

Trajçe Çatmov



# „Suita franceze“

**L**ufta është mizore, por një punë ndaj të cilës nuk kemi fuqi, është dashuria. Me luftë apo pa të, dashurinë e sinqertë nuk e shuan dot askush, t'a ndalë apo t'a zhduk. Por a mund të lind dashuri ndaj armikut, a ka mundësi që lufta të tejkalojë “pluhurin” e luftës dhe të lidh dy njerëz nga taboret e ndryshme të luftës? Filmi “Suita franceze” flet për një dashuri të tillë në kushte të luftës, a dënuar nga rrethi, në mes të oficerit nazist Brunos dhe një francezeje të re me emrin Lusil, dy të lidhur përmes botës së muzikës, njerëzisë dhe mirësisë.

## Mysafiri i paftuar

Bisi, një vend i vogël rural vetëm rreth 20 kilometra larg Parisit, ku banorët bëjnë një jetë të qetë, deri në momentin kur një ditë në këtë fshat do të kalojnë qindra refugjatë të kryeqytetit. Kjo do të thotë vetëm një

gjë – se nazistët e kanë pushtuar Parisin dhe tashmë qyteti qendet nën okupim. Shumë shkurt pas kësaj, Franca edhe zyrtarisht do të bëjë publike se është pushtuar, ndërsa pronat dhe vendbanimet e popullit francez u janë dhënë në dispozicion nazistëve. Në një rën ndër shtëpitë më të bukura dhe më luksoze në Bisi, jetojnë zonja Anzheli dhe reja e saj Lusil. Djali i Anzhelisë dhe bashkëshorti i Lusilit ka shkuar për të luftuar në front për ushtrinë franceze, kundër nazistëve, ndërsa dy gratë udhëheqin punën dhe kujdesin e familjes. Ndërsa puna, jo ai lloj i punës së mundimshme të cilët e punojnë shumë banorë të Bisit, - përbëhet prej nga marrja e tatimeve nga prona e cila është pjesë e familjeve. Por, Anzheli dhe Lusil kanë pikëpamje të ndryshme dhe përderisa njëra e shfrytëzon momentin për të përfituar nga lufta, tjetra përpiqet që gjendjen e tyre

të volitshme financiare t'a shfrytëzojë për t'u ndihmuar njerëzve në nevojë, ndërsa mosmarrëveshjet mes tyre edhe pse nuk vihen në pah dhe nuk shihen nga sytë, janë gjithnjë e më të pranishme përmes një tensioni të qetë të karaktereve diametralisht të kundërta. “Paqa” në këtë “shtëpi grash” do të priset me ardhjen e banorit të ri, oficerit Bruno, i cili është caktuar të jetojë në shtëpinë e tyre. Kërkesa e parë e banorit të ri është e pazakontë – dhënia e çelësit të pianos së mbyllur që është pronë e shtëpisë.

## Kopozitori në uniformën ushtarake

Kush është oficeri misterioz Bruno Fon Falk? Aspak i njejtë me oficerët tjerë nazistë, një prodhim i makinerisë vrastare naziste, edhe pse e ndanë uniformën e njejtë me ta dhe lufton nën të njejtin flamur,

Bruno është një ish pianist dhe kompozitor i cili shumë shpejt pas martesës së tij, dërgohet në front, ashtu që si që do të thotë edhe vet ai, pothuajse nuk ka arritur ta njohë bashkëshorten e tij. Sharmi dhe qetësia e tij, si dhe matura, lënë përshtypje të mirë tek Lusili edhe pse ajo reziston për t'a pranuar këtë person, së pari për shkak se komunikimi me te është i ndaluar nga ana e zojës së shtëpisë – madam Anzhelisë, pore dhe për shkak të ndershmërisë dhe basnikrisë së saj ndaj bashkëshortit i cili është diku në frontin e luftës. Vajza e re, emocionet e thella të së cilës janë të mbyllura, fillojnë të ngriten me hapjen e pianos së saj dhe me meloditë e para të tij, nga gishtat e oficerit, disa melodi të jashtëzakonshme, të panjohura për këtë vajzë të re, nuk rikujtojnë në asnjë të cilën e ka mësuar në shkollën e muzikës. Butësia dhe lehtësia e oficerit, dalnagadalë e zbusin shpirtin e vajzës së re, sidomos edhe kur kupton se martesë e saj është e rrejshme, ndërsa besnikëria e bashkëshortit të saj inekzistente, përnjëherë ajo lëshohet nën pasionin e personit të posa ardhur. Ajo që potencialisht fillon të zhvillohet si një tregim dashurie, përnjëherë ndërpritet me rastin e vrasjes së oficerit nazist nga ana e Benoas – shokut të Lusilit. Përderisa Lusili është e vetmja shpresë për Benoan dhe i ndihmon të largohet nga fshati, pikërisht oficeri Bruno do të jetë i obliguar që t'a gjejë dhe t'i vrasë, të gjithë ata që i ndihmojnë një refugjati.

## Sprovë dashurie

Kush është bukuroshja blonde franceze Lusil? Lucila e re, e rritur, me natyrë të mirë, e nënshtruar, vjen nga një familje borgjeze, por babai i saj ka mbetur pa prona. Megjithatë, ai do të organizojë martesën

e vajzës së tij në një familje të pasur. Fatkeqësisht, martesë në dukje e përsosur e Lusil dhe Gaspar është në thelb e kalbur. Ajo që dinë të gjithë në fshat, përveç gruas së tij, është se Gaspari jo vetëm që është vizitor i shpeshtë i shtretërve të grave të tjera, por ai tashmë ka një fëmijë me një grua tjetër. Pas largimit të tij për në luftë, Lusil mbetet nën kontrollin e nënës së tij të



ftohtë dhe të rreptë, e cila e shtyp plotësisht personalitetin e Lusil nën dominimin e saj, madje e ndalon atë të luajë muzikë piano derisa djali i saj të kthehet në shtëpi. Lusil është pothuajse një e burgosur në shtëpinë e saj, kështu që nuk është çudi që ajo t'i nënshtrohet vëmendjes dhe sharmit të një oficeri gjerman. Ata kanë shumë të përbashkëta dhe ajo që i lidh më shumë është dashuria për muzikën. Dashuria e tyre e ndërsjellë nuk kalon pa u vënë re në fshat, ndaj Lusil bëhet shpejt objekt thashethemesh të egra, veçanërisht nga ata që ishin qiramarrësit e Angelit dhe që për vite paguanin qira shumë të larta. Ndërsa zonja Angeli fsheh dhe mbyll gjithçka që i takon djalit të saj që të mos preket nga duart naziste të Brunos, ai nuk arrin të fshehë edhe gruan e djalit të saj. Dashuria mes Lusil-s dhe Bruno-s është e dukshme dhe e

kudondodhur, megjithëse nuk konsumohet kurrë. Ekziston si një masë, si një peshë në zemrat e tyre, si një lëng rreth tyre, por nuk realizohet dhe nuk flitet. Teksa sjellja e vajzës është e mbyllur, e paqartë, e dridhur dhe e ndrojtur, zëri i saj në rolin e rrëfimitarit zbulon të çarat në zemrën e saj nga të cilat buron forca emocionale e vajzës së re. Dy apostatë që gjejnë paqen dhe qetësinë në praninë e tjetrit. Ndonëse nuk e di, Bruno e mbron nga pamëshirshmëria e luftës, nga shpifjet e bashkëfshatarëve të saj që nuk e humbin rastin të dëmtojnë dhe të fajësojnë një fqinj me nazistët, nga historitë për burrin e saj, nga keqdashja e ushtarët nazistë... ne fund edhe nga kerçenimi se do të vritet, sepse ajo dhe vjehrra janë ekspozuar si ndihmese te te arratisurit Benoit.

"Suita Franceze" është një histori e ngrohtë romantike për një dashuri platonike që lulëzon në mes të një lufte të zezë dhe të errët dhe kurorëzohet me finalizimin e një kompozimi muzikor - suita e ish-kompozitorit Bruno. Filmi bazohet në romanin e Irene Nemirovskit, e cila u vra në kampet e Aushvicit në vitin 1942. Libri tregon shumë më tepër se një histori dashurie, për jetën e francezëve nën pushtimin nazist, për heroizmin dhe frikacakët e njerëzve, për të mirën dhe të keqen, ndërsa filmi mbulon vetëm pjesën e dytë të librit të saj. Pikërisht kjo është ajo që bie më shumë në sy në film - reduktimi i veprës së Irenës në nivelin e një melodrame të holluar. Libri, në dorëshkrim, shtrihej në një valixhe të vjetër për 60 vjet, derisa u gjet nga vajza e Nemirovskit dhe u botua në vitin 2004 si një lloj fitoreje për nënën e saj ndaj nazistëve, e cila vazhdon të jetojë përmes punës së saj.

Elena Gjorgjievska

**Regjia:** Saul Dibb

**Rolet:** Michelle Éilliams, Christine Scott Thomas, Matthias Schoenaerte, Sam Riley, Margot Robbie, Heino Ferch, Tom Schilling, Harriet Éalter

**Skenari:** Matt Charman

**Montazhi:** Christopher Dickens

**Kinematografia:** Eduard Grau

**Muzika:** Rael Jones

**Kohëzgjatja:** 107 minuta

**Vendi:** B. e Madhe/Franca/Gjermania

**Viti:** 2014

**Çmimet:** 4 nominime, si dhe nominim për çmimin kryesor "Emi"





# Fshati Tërnovë – fshat me

**F**shati Tërnovë gjendet në zonën e Sllavishtes, në 15 kilometra në verilindje të Kriva Pallankës. Fshati shtrihet përgjatë kufirit maqedono-bullgar. Ky fshat kufizohet me vendin e quajtur Malla Cërcorija në veri, me Koprivën në verilindje (R. e Bullgarisë) dhe me fshatin Zhidillovë në juglindje, duke përfshirë këtu edhe fshatin Kisellcë në jugperëndim dhe perëndim. Fshati Tërnovë është mjaft i zhvilluar. Fshati është malor dhe mjaft i gjerë, ndërsa mëhallat e tij shtrihen në një lartësi mbidetare nga 900 deri në 1.010 metra. Në fshat gjendet gjithsej 13 mëhalla të cilat kanë numër të ndryshëm të shtëpive. Fshati paraqet një stacion për të ndaluar sepse përgjatë tij ka pasur një rrugë të vjetër antike në drejtim të lindjes (Bullgarisë), ndërsa ka indikacione se në hyrje të fshatit ekzistojnë mbetje të një

lagjeje të vjetër romake të cilat gjithnjë janë të pahulumtuara. Kisha “Shën Nikolla” e cila gjendet në këtë fshat është një kishë manastiri e llojit të ndërtimeve njëkorabe. Në shkencë janë të pranishme dilemat sa i përket vitit të ndërtimit. Në fakt shkencëtarët më të vjetër janë të mendimit se ndërtimet datojnë që nga viti 1505, ndërsa hulumtimet më të reja thonë se kisha është ndërtuar njëqind vite më vonë, gjegjësisht në vitin 1605. Në pjesën lindore është ndërtuar një tram i mbyllur me dy hyrje, ndërsa në pjesën jugore gjendet tremi i hapur. Brendësia e kishës është e formësuar me orar qëndror, në të cilin në pjesën e sipërme përfundon me sfod të gjysmëformësuar. Nga ana piktoreske e kishës mund të veçojmë freskun me lindjen e Krishtit, freskun e shën Nikollës, freskun me shfaqjen e arkitektit


lokal Shën Joakim Sarandoporskit (i Osogovës), kulti i të cilit ka qenë me mjaft ndikim në këto anë. Në afërsi të kishës gjendet shtëpia parohike që ofron kushte për akomodimin e mysafirëve. Gjithashtu ekzistojnë edhe dy objekte, shkolla e vjetër dhe objekti i bashkësisë lokale, objekte këto të cilat kanë potencial për t’u shfrytëzuar edhe në funksion të turizmit. Shumë afër kishës gjendet edhe etno restoranti i posa hapur “Tërnovski Vetar”. Restoranti ka një ambient të shkëlqyeshëm duke ofruar klimën e jashtëzakonshme verore. Restoranti ofron akomodim të ngrohtë dhe komod duke ofruar mundësinë e ikjes nga vapat verore urbane, duke ju akomoduar dhe prenotuar që të kënaqeni në bukuritë malore piktoreske që i ofron kompleksi i posandërtuar.

Kristina Ilievska



**natyrë të jashtëzakonshme**





TË NDERUAR PJESËTARË TË ARMATËS DHE TË PUNËSUAR NË MM,

Redaksia e revistës „Mburoja“ ju inkurajon të dërgoni shkrime rreth aktiviteteve më të rëndësishme në kuadër të njësisë suaj organizative. Shkrimet e juaja, informatat, apo reportazhet me fotografitë përkatëse, mund të na i dërgoni në adresat vijuese:

[zanet.ristovska@mod.gov.mk](mailto:zanet.ristovska@mod.gov.mk) [kristina.ilievska@mod.gov.mk](mailto:kristina.ilievska@mod.gov.mk) [stit@mod.gov.mk](mailto:stit@mod.gov.mk)